



Save the Children

Legjislacioni dhe shërbimet publike për fëmijët në situatë rruge



Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian

Ky botim publikohet në kuadër të projektit “Mbrotjtja dhe integrimi i fëmijëve në situatë rruge në Tiranë”, të **Save the Children** me mbështetjen e Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© Save the Children

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht për qëllime jo fitimprurëse, me kusht që cdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e Save the Children si burim.

Save the Children

Rruga “Komuna e Parisit”, Lagja 8, Pallatet I Maji, Vila “Lami”

Tirana – Albania

Tel: 00355 4 261 840, 929; Fax: 00355 4 263 428

E-mail: info.albania@savethechildren.org

<http://www.scalbania.org>



Save the Children

Legjislacioni dhe shërbimet publike për fëmijët në situatë rruge

STUDIM-RAPORT

Përgatitur nga: Qendra për Mbrojtjen
e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

Prof.Asoc. Dr. Edlira Haxhiymeri
Av.Altin Hazizaj

Përktheu dhe redaktoi Olta Çakçiri

Tiranë, Tetor 2011

FALENDERIME

Ky studim-raport u mundësua me kontributin e:

- 1) Ekipyt të profesionistëve të Qendrës për Fëmijët në Situatë Rruge – projekti i Save the Children me titull “Mbrojtja dhe Integrimi i fëmijëve në situatë rruge”,
- 2) Organizatës shqiptare ”Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë-Të drejtat e Njeriut”, FBSH, partnere në projekt.
- 3) Organizatës ARSIS - Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve, bashkëpunëtore në projekt.
- 4) Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/DCI Shqipëri) dhe ekipit të saj të studiuesve: Prof.Asoc. Edlira Haxhiymeri dhe Av. Altin Hazizaj (Kandidat Doktor në Shkenca Juridike).

Falënderojmë për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre profesionistët nga sektorët që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet publike për fëmijët në situatë rruge si sektori i shëndetësisë, arsimit, policisë dhe njësitë bashkiake/administratorët socialë në qytetin e Tiranës.

Një falënderim i veçantë shkon për fëmijët, prindërit e familjarët e konsultuar për përgatitjen e studim-raportit.

Kontribuan në përgatitjen e raport studimit:

Blerina Kashari, Save the Children, Menaxhere e Programit për Mbrojtjen Fëmijëve

Mirela Jonuzaj, Save the Children në Shqipëri, Koordinatore Programi

Nertila Topulli, Menaxhere e Qendrës për fëmijët në situatë rruge

Klara Simoni - Drejtore Ekzekutive, FBSH

Zini Kore - Drejtor Ekzekutiv ARSIS

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i studimit.....	5
2. Fëmijët në situatë rruge: një fenomen kombëtar dhe global	10
3. Metodologjia e studimit.....	12
4. Mbrojtja dhe kujdesi ndaj fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri	13
5. Legjislacioni dhe fëmijët në situatë rruge.....	26
6. Konkluzione.....	53
7. Rekomandime.....	58
8. Literatura e përdorur	63

Akronime

- ARSIS - Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve
- FBSH - Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë-Të drejtat e Njeriut
- ILO - Organizata Botërore e Punës
- MASH - Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- MPÇSSHB - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- NjMF - Njësi për Mbrojtjen e fëmijëve
- OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë
- OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara
- OJF - Organizata Jofitimprurëse
- VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

I. Qëllimi i studimit

Ky studim-raport është përgatitur në kuadër të Projektit që Save the Children po zbaton në qytetin e Tiranës nëpërmjet “Qendrës për fëmijët në situatë rruge” në Tiranë¹ qysh nga viti 2009, në partneritet me Bashkinë e Tiranës dhe OJF-në shqiptare “Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë - Të drejtat e Njeriut, FBSH”.

**“Qendra për fëmijët në situatë rruge”
Save the Children, Bashkia Tiranë, Fëmijët e Botës
dhe të Shqipërisë, FBSH**

MODEL I MBROJTJES DHE INTEGRIMIT TË FËMIJËVE NË SITUATË RRUGE

Qendra për Fëmijët në situatë rruge ka filluar aktivitetin e saj në shkurt 2009 si një nismë e përbashkët e Save the Children dhe Bashkisë së Tiranës në partneritet me OJF-në shqiptare “Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë, FBSH”.

Qëllimi kryesor i funksionimit të kësaj qendre është të ofrojë dhe sigurojë mbështetje për fëmijët në situatë rruge dhe t’i mbrojë ata nga të gjitha format e shfrytëzimit. Qendra është një ambient që mirëpret çdo fëmijë bazuar në dëshirën dhe vullnetin e tij të lirë të aprovuar nga

1. Përgjatë këtij studim-raporti do të përdorim termin “fëmijë në situatë rruge” që përfshin të gjitha grupet e fëmijëve që jetojnë, punojnë dhe përballen me eksperiencën e rrugës.

prindërit apo të afërmit e tij. Shërbimet dhe mbështetja e ofruar nga Qendra për fëmijët në situatë rruge realizohen duke *respektuar plotësisht parimet e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës*.

Vepriartaria e qendrës për fëmijët në situatë rruge mbështetet edhe në këshillimin me vetë fëmijët përfitues dhe pjesëmarrjen e tyre në hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve “nga fëmijët për fëmijët” dhe në vlerësimin periodik të tyre.

Qendra për fëmijët në situatë rruge ofron shërbime brenda dhe jashtë qendrës për fëmijët dhe familjet e tyre.

Aktivitetet që organizohen në qendër për fëmijët në situatë rruge janë:

- ✓ Klasa përgatitore mësimore (njohuri bazë në shkrim, lexim dhe matematikë) për fëmijët që janë në moshë për regjistrimin në sistemin arsimor publik 9-vjecar
- ✓ Klasa përgatitore për fëmijët që kanë kaluar moshën e lejuar për regjistrim në sistemin arsimor publik 9-vjecar (njohurite bazë në shkrim, lexim matematikë dhe njohuri të përgjithshme)
- ✓ Klasa mbështetëse për fëmijët që janë regjistruar në sistemin arsimor publik 9- vjecar
- ✓ Grupe diskutimi dhe informimi me fëmijët dhe adoleshentët për tema që lidhen me të drejtat e fëmijës, sigurinë dhe rritjen e shëndetshme të tyre (sipas grupmohave dhe gjinive)
- ✓ Aktivitete psiko-social-edukative sipas grupmohave dhe gjinive
- ✓ Aktivitete argëtuese, kulturore dhe sportive
- ✓ Kurse kompjuteri sipas grupmohave të caktuara
- ✓ Ndërmjetësim social-kulturor mbi kulturën rome & egjiptiane
- ✓ Këshillim dhe diskutim me përfaqësues të komunitetit

Çdo aktivitet që realizohet në qendër është i mbështetur dhe lehtësuar nga stafi i profesionistëve i përbërë nga punonjës socialë, psikologë, animatorë, mediatorë kulturorë, mësues si dhe nga stafi drejtues. Metodologjia e aplikuar nga projekti i qendrës për fëmijët në situatë rruge është ndërmjetësimi kulturor që konsiston në ndërtimin e marrëdhënies së besimit me fëmijët dhe komunitetin e tyre përfaqësues.

Qendra mirëpret çdo ditë prindër dhe familjarë të fëmijëve për konsultime, këshillime dhe informim lidhur me shërbimet publike, nevojat

për lehtësim të procedurave administrative dhe referimin në shërbimet publike nëse nevojitet.

Një nga elementët kryesorë të aktivitetit të qendrës është puna në komunitet (në vendin ku fëmijët dhe familjet e tyre punojnë dhe jetojnë) nëpërmjet ekipit të operatorëve të terrenit. Ky ekip ka në përbërjen e tij punonjës socialë dhe mediatorë kulturorë të cilët kryejnë vizita periodike në komunitet duke realizuar:

- ✓ *Monitorim dhe vlerësim të kushteve socio-ekonomike të fëmijëve dhe familjeve të tyre*
- ✓ *Evidentim, dokumentim dhe adresim të problematikave të identifikuara;*
- ✓ *Informimin e prindërve/të afërmeve dhe fëmijëve për ekzistencën e shërbimeve publike si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre;*

Fokusi i punës është ndërmjetësimi për fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre për përfitimin nga shërbimet publike dhe ato private nëse nevojitet, kryesisht për:

- *regjistrimin e çdo fëmije që identifikohet i paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke ndjekur procedurat e duhura*
- *vaksinimin e çdo fëmije që identifikohet i pavaksinuar*
- *vizita mjekësore në institucione shëndetësore për fëmijët dhe mbështetje me medikamente*
- *regjistrimin në arsimin publik parashkollor dhe 9-vjeçar duke ofruar parapërgatitje në ambientet e qendrës, mbështetje me materialet e nevojshme dhe monitorim të frekuentimit dhe rezultateve të arritura*
- *regjistrimin e adoleshentëve pranë kurseve të formimit profesional duke ofruar një parapërgatitje në ambientet e qendrës, mbështetje me materialet e nevojshme dhe monitorim të frekuentimit dhe rezultateve të arritura*

Bashkëpunimi midis aktorëve publikë dhe privatë për të forcuar mbrojtjen dhe mbështetjen që u ofrohet fëmijëve të rrugës dhe për të kontribuar në zhvillimin e tyre të shëndetshëm konsiderohet si elementi kyç në zbatimin e këtij projekti.

Grupi multidisiplinar i profesionistëve për mbrojtjen e integrimin e fëmijëve në situatë rruge

Projekti “Mbrojtja dhe integrimi i fëmijëve në situatë rruge” i zbatuar nëpërmjet Qendrës për fëmijët në situatë rruge ka në fokusin e tij ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të sektorëve të lidhur drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve në arsim, shëndetësi e shërbim social, të pushtetit lokal (punonjësve të zyrave përkatëse në çdo Njësi Bashkiake në Tiranë) dhe të strukturave të policisë, duke synuar plotësimin e nevojave dhe të drejtave të tyre. Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të përditshme dhe për mirëfunksionimin e qendrës, qysh në fillimet e saj u pa i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë mes strukturave të pushtetit qendror dhe atij lokal si Drejtoria Arsimore Tiranë, Agjencia Rajonale e Shëndetit, Qendrat Shëndetësore, Drejtoritë e shkollave 9-vjeçare, Njësitë Bashkiake në qytetin e Tiranës (administratorët socialë) dhe strukturat e policisë.

Kështu u krijua një grup profesionistësh¹ për mbrojtjen e fëmijëve me përfaqësues nga strukturat e mësipërme i cili ka si qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe ndërtimin e aplikimin e një modeli qasjeje multidisiplinare dhe sa më profesionale në punën me fëmijët në situatë rruge. Angazhimi i institucioneve të sipërpërmendura konsistoi në miratimin e një marrëveshjeje ndërinstucionale që përcakton pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në projekt dhe në ofrimin shërbimeve për fëmijët në situatë rruge.

Mbi 20 profesionistë nga sektorët e mësipërm, anëtarë të këtij grupi, kanë qenë pjesë aktive e sesioneve² për ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës duke sjellë raste specifike nga puna e tyre e përditshme, duke identifikuar dhe dokumentuar problematikën përkatëse dhe duke diskutuar në grup multidisiplinar zgjidhjen e tyre në interesin më të lartë të fëmijës.

1. Grupi i Punës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

2. Maj 2010-Shtator 2011

Studim-raporti është hartuar mbi bazën e raporteve, studimeve dhe të dhënave të mbledhura në mënyrë direkte dhe intervistave me profesionistë, nëna dhe fëmijë që kanë eksperiencë në përballjen me rrugën dhe në problematika të tjera që lidhen me mungesa dhe vështirësi në sigurimin e një jete normale.

Në të njëjtën kohë, raporti ndalet në analizën e ligjeve dhe politikave, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të parë se cila është mbrojtja që ligji u ofron fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri dhe, mbi të gjitha, cilat janë hapësirat dhe boshllëqet që legjislacioni ka në lidhje me mbrojtjen dhe kujdesin e përshtatshëm për fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre për integrimin e tyre në tregun e punës dhe në sistemin e ndihmës sociale.

Pas analizës së të dhënave nga burime parësore dhe dytësore, në studim-raport identifikohet problematika më e mprehtë me të cilën përballlet kjo kategori dhe jepet një listë rekomandimesh drejtuar institucioneve dhe aktorëve të ndryshëm të përfshirë në zbatimin dhe zgjidhjen e problemit.

Studim-raporti synon:

- Të identifikojë mangësitë ligjore dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit për sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijët në situatë rruge
- Të analizojë rolin e strukturave shtetërore (qendrore dhe vendore) dhe mekanizmave përkatëse (Shërbimi Social Shtetëror, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, administratorët etj.) në mbrojtjen e fëmijëve
- Të identifikojë vështirësitë e koordinimit midis strukturave dhe mekanizmave
- Të vlerësojë faktorët që nxisin ekspozimin e fëmijëve ndaj punës në rrugë

2. Fëmijët në situatë rruge: një fenomen kombëtar dhe global

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka bërë një vlerësim të numrit të fëmijëve në situatë rruge në botë dhe ka arritur në përfundimin se ky numër shkon deri në 150 milionë fëmijë dhe ka tendencë të rritet. Po sipas kësaj organizate, mosha e fëmijëve në situatë rruge është nga 3 deri në 18 vjeç. 40% e tyre janë të pastrehë. 60% të tjerët punojnë në rrugë për të siguruar ushqimin e familjeve të tyre. Një numër i konsiderueshëm i fëmijëve në situatë rruge detyrohen nga prindërit e tyre tejet të varfër të lypin ose të punojnë. Ata e kanë të pamundur të ndjekin shkollën dhe kushtet e tyre të jetesës vlerësohen si “jashtëzakonisht të vështira”. Gjithnjë e më shumë fëmijët në situatë rruge po bëhen viktimat të pambrojtura të dhunës brutale, shfrytëzimit seksual, neglizhimit, abuzimit me substanca kimike dhe shkeljes së të drejtave të njeriut¹. Në raportet e vendeve të ndryshme për fëmijët në situatë rruge referohen raste nga më të ndryshmet, duke filluar që nga fëmijët e familjeve të varfra; fëmijët jetimë; fëmijët e braktisur; fëmijët e familjeve me një prind, me prindër të divorcuar apo me prindër me probleme të shëndetit apo të alkoolit; fëmijët e familjeve Rome etj, të gjithë të detyruar, në një mënyrë ose në një tjetër, të dalin në rrugë për të siguruar mbijetesën e familjes dhe të vetes.

UNICEF ka përcaktuar tre tipa të fëmijëve të rrugës: *fëmijë që jetojnë në rrugë, fëmijë që punojnë në rrugë dhe fëmijë të familjeve që jetojnë në rrugë.*

Çështja e përkufizimit të fëmijëve në situatë rruge ka hapur debate të cilat kanë gjetur një përgjithësim nga Sarah Thomas Benitez në “Bota e fëmijëve të rrugës: Dhuna”.

Ajo thotë se “fëmijët e rrugës”, sipas shumë sociologëve dhe antropologëve, nuk përbëjnë një kategori sociale të mirëpërcaktuar e me një popullsi homogjene dhe vetë fenomeni mbetet i papërkufizuar

1. PANGEA - Street Children - Community Children Worldwide Resource Library

saktësisht (Glaser, 1990; Enneë, 2000; Moura, 2002). Përkufizimi “Fëmijë në situatë rruge” përfshin fëmijë të një spektri të gjerë rrethanash dhe karakteristikash të cilat hartuesit e politikave dhe ofruesit e shërbimeve e kanë të vështirë t’i përshkruajnë dhe targetojnë. Një nga karakteristikat që bashkon “fëmijët e rrugës” është fakti se të gjithë ata, djem dhe vajza të të gjitha moshave, jetojnë dhe punojnë në vende publike, në vende të dukshme, në shumicën e qendrave të mëdha urbane në mbarë botën¹.

Fëmijët përfundojnë në rrugë për shumë arsye. Ata mund të mos kenë zgjedhje tjetër – mund të jenë braktisur ose mohuar nga prindërit ose mund të kenë mbetur jetimë. Gjithashtu, ata mund të zgjedhin të jetojnë në rrugë për arsye keqtrajtimi apo neglizhimi ose për faktin se familja e tyre nuk ka mundësi t’u sigurojë plotësimin e nevojave minimale.

Shumë fëmijë punojnë në rrugë sepse fitimet e rrugës u nevojiten familjeve të tyre. Familjet janë pjesë e shoqërisë dhe varfëria e mjerimi i tyre është shprehje e problemeve sociale, ekonomike, politike e mjedisore që shoqëria përjeton.

Raporti i OBSH-së në 1993 rendit shkaqet e mëposhtme për këtë fenomen²:

- shpërbërja e familjes
- konfliktet e armatosura
- varfëria
- fatkeqësitë natyrore apo njerëzore
- zija e bukës
- abuzimi fizik dhe seksual
- shfrytëzimi nga të rriturit
- lëvizjet migratore
- urbanizimi dhe mbipopullimi
- përjashtimi social/diskriminimi
- mohimi prindëror.

1. Faqe 8, Section 2.2. “State of the World’s Street Children-Violence” (PDF). www.streetchildren.org.uk. Retrieved 2008-02-05

2. “Street Children:WHO 3 of 9”. www.pangaea.org. Retrieved 2008-02-05.

3. Metodologjia e studimit

3.1 Mjetet kryesore të kërkimit

Ekspertët që punuan në hartimin e këtij studim-raporti përdorën metodën e analizës së kryqëzuar midis burimeve primare dhe sekondare. Për të siguruar informacion primar, u realizuan intervista me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe agjencive joqeveritare që punojnë me dhe për fëmijët në situatë rruge. U realizuan gjithashtu fokus grupe dhe intervista me fëmijë dhe të rinj.

Të dhënat dytësore u mundësuan nga shfrytëzimi i literaturës ekzistuese, vendase dhe të huaj. Shfrytëzimi i literaturës ekzistuese (studime, raporte, artikuj të realizuar nga studiues vendas dhe organizata lokale e ndërkombëtare, ligje dhe politika të shtetit shqiptar nga viti 1990 e në vijim) ka shërbyer për të identifikuar problematikën mbi të cilën duhet hulumtuar dhe mangësitë në legjislacion, sidomos në drejtim të zbatimit të tij.

Intervistat me aktorët kyç në fushën e shërbimeve për fëmijët në situatë rruge, intervistat me profesionistët (mjekë, mësues, punonjës policie, juristë, punonjës socialë dhe psikologë) si dhe intervistat me prindër dhe fëmijë në situatë rruge shërbyen për të provuar ekzistencën e problemeve, shkallën e tyre, shkaqet dhe nevojat për ndërhyrje si dhe për të marrë sugjerimet nga gjithë aktorët e interesuar.

3.2 Vështirësitë e ndeshura në realizimin e studim- raportit

Studiuesit ndeshën një sërë vështirësish dhe pengesash gjatë përgatitjes së studim-raportit. Në shumicën e rasteve, çështje të tilla u kapërcyen përmes përdorimit të burimeve sekondare ose përmes teknikave të kontrollit të dyfishtë.

Studiuesve iu desh të përballeshin me mungesën e studimeve specifike mbi shfrytëzimin e fëmijëve për qëllime ekonomike dhe mbi lypjen si fenomen social apo të të dhënave sasiore në lidhje me numrin e fëmijëve e familjeve që jetojnë në situatë rruge. Edhe pse jo një faktor përcaktues,

ekzistenca e një baze me njohuri të tilla do t'i kishte ndihmuar studiuesit në përpjekjen e tyre për një analizë krahasuese të dhënash dhe identifikimi të tendencave. Ndërkohë, shumica e studimeve ekzistuese prekin vetëm çështjen e trafikimit të fëmijëve duke qenë se kjo është një dukuri shumë e përhapur në Shqipëri prej vitesh.

Një tjetër vështirësi ishte mungesa e statistikave/të dhënave specifike mbi forma të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve.

4. Mbrojtja dhe kujdesi ndaj fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri

Nuk ekziston asnjë studim mbarëkombëtar i cili të mund të japë një pasqyrë të plotë të fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri. Në këto kushte, është shumë e vështirë të vlerësosh përmasat e fenomenit, profilin e fëmijëve, prejardhjen e tyre dhe shkaqet që e ushqejnë këtë fenomen në një nivel krahasimor (d.m.th. si ka qenë situata dhe nëse ka ardhur duke u përmirësuar apo përkeqësuar me kalimin e viteve).

Gjithsesi, ne do t'i përmbahemi përkufizimit të sipërcituar për sa i përket kategorizimit të tyre. Studim- raporti do të fokusohet tek fëmijët me ose pa familje që kalojnë pjesën më të madhe të ditës në rrugë, pa shkuar në shkollë, të rrezikuar nga faktorë të ndryshëm në mungesë të shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

4.1 A është lypja dhe jetesa në rrugë një fenomen i lidhur me komunitetin Rom?

Ndërsa përpiqemi të hulumtojmë në origjinën e fëmijëve në situatë rruge që kemi në objekt të studimit, ndeshim vazhdimisht në vlerësimin e specialistëve të fushave të ndryshme opinionin që “shumica e fëmijëve në situatë rruge i përkasin komunitetit Rom”. Ky studim-raport refuzon ta marrë këtë si një të vërtetë absolute për sa kohë vlerësimi nuk mbështetet në të dhëna faktike (shifra dhe fakte konkrete mbi të gjithë fëmijët në situatë rruge).

Mbështetur në evidencat e projektit “Mbrojtja dhe Integrimi i fëmijëve

në situatë rruge”, ne do të pranojmë se shumica e fëmijëve në situatë rruge janë nga komuniteti Rom, duke marrë parasysh njëkohësisht faktin që, në këtë grup të rrezikuar fëmijësh, ka edhe fëmijë nga komunitete dhe shtresa të tjera të shoqërisë.

4.2 Çfarë ndodh në praktikën e punës me fëmijët në situatë rruge?

4.2.1 Fëmijët në situatë rruge dhe e drejta e tyre për arsim bazë

Sipas intervistave me specialistët, rezulton se “fëmijët që kanë përjetuar eksperiencën e rrugës e kanë të vështirë të pranohen nga mjedisi social, përfshirë këtu edhe mësuesit”.

Shqipëria ka miratuar Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar, dy dokumente të rëndësishme për zhvillimin e arsimit në vend. Të dy këto dokumente ligjorë dhe politikë konfigurojnë praktikën e shtetit shqiptar në aplikimin e parimeve të përgjithshme dhe atyre kushtetuese. Midis të tjerash, në këto dokumente shprehet qëllimi për të “*rritur përfshirjen e fëmijëve nga shtresat e varfra në arsimin e detyrueshëm*”. Në dokumente parashikohet ngritja e klasave parapërgatitore për fëmijët e grupeve në nevojë, përfshirë fëmijët romë, të cilët përgatiten për t’u futur në klasë të parë¹.

Në Progres-Raportet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës thuhet se, gjatë vitit 2003/2004, kjo Ministri ka shpërndarë tekste shkollore falas për fëmijët e grupeve në nevojë, përfshirë fëmijët e komunitetit Rom. Gjatë periudhës 2004-2007 janë shpërndarë libra falas për fëmijët e prindërve të papunë. Gjatë vitit 2008 fëmijët e prindërve në asistencë sociale duhet të paguanin vetëm 10% të kostos së librave². Në vitin 2009 Këshilli i Ministrave mundësoi rimbursimin 100% të kostos së teksteve shkollore për fëmijët e arsimit fillor që vinin nga familje në nevojë të cilat mbështeteshin me ndihmë ekonomike.

Në Raport Progresin e 2007 theksohet se “fatkeqësisht, librat mbërrijnë

1. Faqe 17, Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar

2. Progres Raporti i Strategjisë 2007, fq. 29

vonë dhe prindërit e fëmijëve romë nuk arrijnë të përfitojnë nga kjo ndihmë. Ata nuk janë të regjistruar si të papunë, kështu që nuk plotësojnë kriteret për ndihmë ekonomike. Sipas procedurave të vitit 2007, prindërit duhet t'i blinin fillimisht librat dhe pastaj të rimbursoheshin në masën 100% apo 90%. Prindërit romë nuk kanë pasur të ardhura, rimbursimi është vonuar dhe, për këto arsye, shumë prej tyre nuk kanë përfituar¹. Situata e mësipërme duket e kapërcyer me aktet nënligjore të viteve të fundit. Megjithatë, në të vërtetë, kësaj shtate nuk i është dhënë fund, pavarësisht miratimit të VKM-ve përkatëse (VKM Nr. 212, datë 16.03.2011 Për disa shtesa dhe një ndryshim në Vendimin Nr. 107, datë 10.02.2010, të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar").

Më poshtë po paraqesim mendimin e specialistëve:

Njëri prej tyre shprehet: *"Edukimi i fëmijëve që vijnë nga familjet e varfra (Rome apo jo rome) mbetet problematik. E drejta për arsimim është një e drejtë bazë e fëmijëve që sanksionohet edhe në Kushtetutë kur thuhet se arsimi i detyruar publik është falas. Aktet nënligjore si Dispozitat për arsimin parauniversitar kanë përcaktuar detyrimin e prindërve, qeverisjes vendore dhe institucioneve arsimore për të siguruar edukimin e të gjithë fëmijëve në moshë shkollore. Ky dokument ligjor parashikon edhe penalitetet për shkelësit e ligjit.*

Ajo që ndodh në realitet është larg panoramës që parashikohet në legjislacion. Prindërit me të ardhura të kufizuara ose të munguara e kanë të pamundur përballimin e kostos së shkollimit të fëmijëve. Në disa raste ata janë të papunë. Detyrimi i tyre për të shkolluar fëmijët por edhe penalizimi nuk mund të realizohet. Njësitë e qeverisjes vendore e kanë të pamundur të zbatojnë ligjin por ato janë edhe të paafta të ofrojnë zgjidhje alternative për të siguruar respektimin e të drejtës themelore dhe kushtetuese të këtyre fëmijëve për arsimin e detyruar. Shpesh këta fëmijë nuk identifikohen dhe humbasin në vorbullën e jetës së përditshme".

Një tjetër thotë: *"Kur familja nuk është në gjendje të sigurojë shkollimin e fëmijës, qeverisja vendore nuk mundëson zbatimin e ligjit, institucioni i shkollës nuk lidhet me sistemin. Shkolla nuk ka detyrim ligjor për ta mbajtur fëmijën*

1. E njëjtë si me lart

në shkollë. Shkolla me të gjithë strukturën e saj nuk realizon dot zbatimin e të drejtave të fëmijës për edukim”.

Në një kohë kur flitet për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe kur shoqëria moderne përpiqet të krijojë kushte për kthimin në arsim për qytetarët e të gjitha moshave, qoftë edhe vetëm për rifreskim, fëmijëve u mohohet e drejta për arsim duke krijuar kështu një diskriminim që është në shkelje të të gjithë ligjeve të sipërpërmendura.

Specialistët e intervistuar shprehen të shqetësuar se mjedisi i arsimit nuk është mbështetës për fëmijët në situatë rruge, por edhe për kategori të tjera fëmijësh në vështirësi.

Një prej tyre tregon: *”Në shkollën tonë u paraqit për t’u regjistruar në klasë të parë një vajze Rome. Ajo rrinte e mënjanuar pasi fëmijët e tjerë nuk e pranonin. Fëmijët e klasës përpiqeshin të evidentonin në çdo rast sjelljet e saj të ndryshme nga ato të të tjerëve. Ata, madje, filluan ta vëzhgonin edhe pas mësimit. E kishin kapur duke kërkuar kanoçe në plehra. Filluan ta tregojnë me gisht. Ajo ndihej keq. Ndërkohë, shkolla nuk bënte asgjë për ta mbrojtur. Ajo iku në heshtje... Askush nuk u kujdes për të. Fëmijët ishin paragjykses të mësuar prej prindërve paragjykses. Ka raste kur prindërit jo romë kërkojnë largimin e fëmijëve romë nga klasa e fëmijës së tyre. Mësuesit dhanë prova se ishin po aq paragjykses. Janë shënuar raste në të cilat drejtuesit e shkollave nuk pranojnë të regjistrojnë fëmijë të komunitetit Rom apo fëmijë në situatë rruge”.*

Të tjerë specialistë shprehen:

“VKM për shpërndarjen e librave falas për fëmijët romë dhe VKM për rimbursimin e librave për fëmijët e familjeve me të ardhura të kufizuara nuk kanë gjetur zbatim. Fëmijët romë nuk i marrin librat falas sepse një pjesë e tyre nuk shkojnë në shkollë pasi nuk janë të regjistruar në gjendjen civile. Fëmijët e familjeve të varfra nuk kanë para për të blerë fillimisht librat kështu që rimbursimi nuk mund të ndodhë për ta”.

“Aktet nënligjore duket se janë sipërfaqësore dhe jofunksionale. Ato nuk shoqërohen me procedura zbatuese”.

“Fëmijët që shkojnë në shkollë pa libra ndëshkohen, turpërohen dhe, në një mënyrë apo tjetrën, nxirren jashtë nga klasa”.

“Fëmija nxirret nga klasa dhe turpërohet edhe kur nuk ka mjetet e

nevojshme për mësim”.

“Shkolla merr një pozicion të kundërt me qëllimin për të cilin është ndërtuar: shkolla kthehet në paragjyquese, përjashtuese për një pjesë të fëmijëve që nuk kanë mundësinë të kompletohen me mjetet shkollore”.

Në disa raste, prindërit i bashkohen këtij qëndrimi të shkollës duke kërkuar largimin e fëmijëve me ngjyrë apo largimin e fëmijëve që nuk kanë mjetet shkollore.

“Në aspektin e arsimimit, varësia e fëmijës nga të rriturit mund të jetë me pasoja tepër të rënda për fëmijën. Hyrja në shkollë kushtëzohet me paraqitjen e disa dokumenteve (regjistrimi në gjendjen civile, adresa e banesës, kontrata e qerasë etj.) që janë përgjegjësi e të rriturve. Kur të rriturit nuk i përmbushin dot këto përgjegjësi, viktimat janë fëmijët. Ata mbeten pa u regjistruar”.

“Sistemi nuk siguron respektimin e të drejtës së fëmijës pavarësisht statusit dhe gjendjes së familjes së tij”.

“Mësuesit duket se po zbehin rolin e tyre si agentë socialë. Ndodh që mësuesi reflekton në punën e tij paragjykime dhe stereotipa që dominojnë komunitetin por janë të papranueshme për rolin dhe misionin e tij”.

“Në praktikë është vërtetuar se mësuesit nuk i përfshijnë këta fëmijë në aktivitetet mësimore. Nuk u japin detyra, nuk i pyesin, nuk i përfshijnë në lojëra, i dënojnë dhe i largojnë dalëngadalë nga mjedisi shkollor. Ndërkohë, legjislacioni nuk parashikon asnjë lloj penaliteti për mësuesit që shkelin të drejtat e fëmijëve dhe nuk mundësojnë zhvillimin e edukimit e barabartë të fëmijëve pavarësisht racës, klasës dhe shtresës që ata u përkasin”.

“Mësuesi mbetet brenda mureve të shkollës dhe kontaktet e tij me familjarët e fëmijëve, ndihma jashtë procesit, mbështetja për të siguruar burime etj. mungojnë”.

“Shërbimi psikologjik në shkollë është larg nevojës dhe qëllimeve për të cilat është ngritur. Shtimi i problematikave të fëmijëve në shkollë kërkoj edhe ngritjen e shërbimit psikologjik, por shërbimi i kufizuar nuk i ofron asnjë kontribut shkollës dhe aq më pak fëmijëve në nevojë”.

“Procesi i rekrutimit të mësuesve duhet riparë. Nuk mund të punësohen si mësues individë që janë paragjyqes dhe përjashtues kundrejt fëmijëve”.

Në mënyrë të përmbledhur, edukimi i fëmijëve në situatë rruge përballet me disa problematika.

1. Është e vërtetë se ekziston një kuadër ligjor që siguron arsimimin e të gjithë fëmijëve por mungojnë mekanizmat për të kontrolluar zbatimin e tij.
2. Fëmijët e prindërve në vështirësi, pa të ardhura, me probleme shëndeti etj. e kanë të pamundur të ndjekin shkollën. Përgjegjësia bie mbi prindërit. Ligji ngarkon dhe penalizon prindërit por, kur prindërit janë pa burime materiale, ata as mund të penalizohen e as mund të detyrohen.
3. Njësitë e qeverisjes vendore janë të pafuqishme por edhe të paafta të aplikojnë ligjin. Strukturat e tyre nuk realizojnë identifikimin e fëmijëve në moshë shkollore. Nuk ndjekin regjistrimin e përfshirjen e tyre. Kur familjet janë të pargjistruara, situata rëndohet pasi edhe mundësia për ndërhyrje është pothuaj e pamundur.
4. Kur fëmijët në situatë rruge arrijnë të regjistrohen, falë edhe mbështetjes së shoqatave dhe shërbimeve të tyre, frekuentimi i shkollës vështirësohet për arsye se:
 - këta fëmijë bien pre e paragjyqimeve dhe diskriminimit që ushtrohet nga fëmijët e tjerë, prindërit e tyre dhe mësuesit;
 - mësuesit janë të painteresuar të përfshijnë fëmijët në situatë rruge në aktivitetet mësimore, i injorojnë ata, i lënë jashtë vëmendjes dhe nuk mundësojnë përfshirjen e tyre në aktivitete alternative; ata duket se në disa raste kanë hequr dorë nga përgjegjësitë e tyre qytetare;
 - drejtuesit e shkollave bien vetë pre e paragjyqimeve dhe bëhen pengesa e parë në përfshirjen e fëmijëve në situatë rruge në shkollë. Ata bëhen dhunues të ligjit dhe askush nuk parashikon penalizime dhe ndëshkime të tyre;
 - shërbimi psikologjik në shkollë është formal dhe nuk ofron asgjë konkrete për fëmijët në situatë rruge;
 - aktet nënligjore të hartuara për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të familjeve të varfra nuk e kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë hartuar. Ato nuk kanë prodhuar një rezultat pozitiv në

- favor të fëmijëve;
- frekuentimi i shkollës lihet në dorë të fëmijës; nuk funksionon monitorimi;
- ka raste që fëmija i cili nuk ka frekuentuar rregullisht, është kalues në fund të vitit. Informaliteti është në dëm të fëmijës; fëmijët në situatë rruge janë shpesh viktimë të këtij informaliteti të formalizuar;
- klasat parashkollore që funksionojnë në disa raste, nuk ia kanë dalë të afrojnë fëmijët e varfër dhe ata të shtresave në nevojë;
- shkolla duket se rrezikon të bëhet përjashtuese duke shkuar ndesh me misionin e saj.

4.2.2 Kujdesi shëndetësor dhe ndihma mjekësore

Në raportin e UNDP-së për popullsinë Rome në Shqipëri (2006) thuhet se “të dhënat zyrtare për gjendjen shëndetësore të popullsisë Rome në Shqipëri janë të pakta. [...] Sidoqoftë, është e vërtetuar se shëndeti i popullsisë Rome është përkeqësuar shumë më shumë sesa shëndeti i pjesës tjetër të popullsisë në transicion (De Soto and others, 2002). [...] Shifrat tregojnë një incidencë të lartë të sëmundjeve pulmonare dhe astmës midis popullsisë rome. [...] Kjo popullsi përjeton mungesë të aksesit ndaj shërbimeve si rezultat i mosregjistrimit”¹.

Por, çfarë thonë specialistët e punës direkte me fëmijët në situatë rruge dhe fëmijë të tjerë të rrezikuar nga mungesa e shërbimit?

Në vlerësimin e aplikimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, specialistët e punës në terren me fëmijët në situatë rruge sjellin edhe shembuj të tjerë nga fusha e shërbimeve. Kështu, mjeku i ekipit multidisiplinar tregon se “fëmijët romë trajtohen si ilegalë”.

Mënyra se si ata referohen e bën të vështirë trajtimin e tyre. Nëse do të paraqiteshin pranë qendrave shëndetësore me prindërit e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, atyre do t’u duhej të paguanin për shërbimin e marrë. Mirëpo, për një pjesë të tyre kjo është e pamundur. Kështu, për të ndihmuar këta fëmijë, mjekët vendosen në një pozicion antiligjor. Ata ofrojnë shërbimin në shkelje të ligjit. Mungesa e librezës

¹. At Risk, Roma and the Displaced in Southeast Europe, UNDP, 2006, p. 27

shëndetësore diskriminon fëmijët e familjeve Rome dhe të të gjithë familjeve të tjera që nuk paguajnë sigurime shëndetësore për arsye të papunësisë dhe varfërisë. Pajisja me librezë shëndetësore nuk varet prej fëmijëve. Ajo është përgjegjësi e prindërve dhe të rriturve që janë përgjegjës për fëmijët. Vështirësitë e të rriturve vënë në rrezik statusin e fëmijëve. Ndërkohë, shteti nuk arrin të kompensojë me ndërhyrje për të mundësuar respektimin e parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Kushtetutës.

Mjekët, punonjësit socialë të qendrës ditore, drejtuesit e shoqatave që janë të fokusuara në shërbime ndaj fëmijëve në situatë rruge si dhe prindërit e fëmijëve u shprehën me shqetësim lidhur me mundësitë që kanë këta fëmijë për të marrë shërbimin e nevojshëm shëndetësor.

Të intervistuarit shprehin shqetësimin se fëmijëve në situatë rruge u shkelet e drejta kushtetuese për shërbim shëndetësor falas. Fëmijët bëhen viktima të situatës në të cilën ndodhen prindërit e tyre dhe sistemi ekzistues nuk i merr në mbrojtje. Për nga mënyra me të cilën funksionon sot, sistemi është përjashtues, diskriminues dhe antikushtetues për fëmijët në situatë rruge. Udhëzimi Nr. 526, datë 12 tetor 2009, i Ministrisë të Shëndetësisë përjashton nga përfitimi i shërbimit shëndetësor falas familjet në nevojë e, në mënyrë të veçantë, komunitetin Rom pasi në shumicën e rasteve përfaqësuesit e këtyre grupimeve janë të paregjistruar në gjendjen civile të qytetit të Tiranës dhe nuk janë të pajisur me librezë shëndetësore. Ofruesit publikë të shërbimeve shëndetësore nuk duhet të presin derisa popullsia Rome të drejtohet tek ata; është detyrim i tyre ligjor që aksesin në shërbim t'ua garantojnë të gjithë qytetarëve, duke ofruar edhe zgjidhjet përkatëse për popullsitë e lëvizshme apo që kanë mungesë dokumentacioni.

Aktualisht, i vetmi shërbim që ofrohet falas dhe pa detyrimin për të qenë të siguruar është vaksinimi.

Gjendja e shërbimit shëndetësor është edhe më e rëndë po të kemi parasysh shërbimet e specializuara siç janë mjeku stomatolog, okulisti, psikiatri etj., shërbime të cilat në shumicën e rasteve ofrohen vetëm përkundrejt pagesës.

Fëmijët në situatë rruge, duke pasur mangësi të theksuara në ushqyerje, higjienë dhe kushte banimi, janë më të rrezikuar nga problemet e mprehta shëndetësore.

Në mungesë të regjistrimit të familjes dhe plotësimit të detyrimeve që përcakton ligji për të marrë shërbimet e nevojshme pa pagesë, fëmijët në situatë rruge janë totalisht të pambrojtur nga sistemi.

Ndërhyrjet e realizuara përmes shërbimeve të ofruara prej shoqatave të ndryshme janë vetëm modele pozitive të mundësive që ekzistojnë për ta ndryshuar realitetin e këtij grupi fëmijësh. Por, ato kurrësi nuk mund të plotësojnë gjithë nevojat që ekzistojnë.

4.2.3 Mirëqenia dhe siguria sociale

Nga intervistat me specialistët e terrenit dhe përfituesit e shërbimeve mësuam se:

“Ky shërbim mbetet jofunksional. Mungojnë shërbimet në terren. Mungon rrjeti i organizuar i shërbimeve dhe referimeve. Në rast se merr përsipër të mbrosh një fëmijë, nuk gjen shërbime të lidhura në rrjet. Duhet të mbash përgjegjësi për të gjithë nevojat dhe shërbimet ndaj fëmijës”.

“Shërbimet ndaj fëmijëve në situatë rruge janë shumë të kufizuara. Mbahen kryesisht me fondet e donatorëve të huaj dhe janë të rrezikuara në vazhdimësinë e tyre”.

“Shërbimi social kombëtar kryen vetëm inspektime por mungon ofrimi i shërbimeve”.

“Personeli i shërbimeve sociale në institucionet e qeverisjes vendore është i fokusuar vetëm në ndarjen e ndihmës ekonomike. Specialistët e këtij sektori nuk bëjnë inspektime në terren”.

“Identifikimi i fëmijëve në nevojë nuk bëhet. Koordinatorët e komunitetit, personeli i zyrës për shërbime sociale dhe pjesa tjetër e administratës vendore nuk bashkëpunojnë për të siguruar identifikimin e rasteve problematike dhe referimin për ndihmë tek shërbime të tjera alternative”.

“Familjet e fëmijëve në situatë rruge e kanë të pamundur të plotësojnë dokumentet për ndihmë dhe shërbime sociale. Ata janë rëndom viktimë të mungesës së informacionit që i shoqëron. Në njësitë e qeverisjes vendore nuk ka shërbime mbështetëse për informim dhe plotësim dokumentesh”.

“Ndërthurja dhe komplikimi i problemeve me të cilat përballen familjet e fëmijëve në situatë rruge e bën shpeshherë të pamundur mbështetjen e tyre. Ka raste kur fëmijët e familjeve të rrezikuara nuk mundën të marrin as bonusin e lindjes”.

Një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë në kushte fizike dhe materiale aspak të përshtatshme. Këto kushte i vënë fëmijët në një situatë diskriminimi dhe pabarazie që në fazën e parë të jetës. Ndërkohë që diskriminimi dhe pabarazia janë të ndaluara me Kushtetutë dhe me Ligj, asnjë masë nuk merret në praktikë për të identifikuar rastet dhe për të ndërhyrë me procedura mbrojtëse në interesin më të lartë të fëmijës siç mund të jenë heqja e të drejtës prindërore përkohësisht apo përgjithmonë, mbështetja e familjes me shërbime plotësuese të emergjencës etj.

Zyrat e shërbimeve sociale pranë Njësive të Qeverisjes Vendore nuk bëjnë inspektime në terren për të identifikuar problemet. Në Tiranë ekziston vetëm një Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve si entitet legjitim për mbrojtjen e fëmijëve, e hapur rishtazi në njësinë bashkiake Nr. 4.

Oficerja e policisë pranë zyrës së Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje¹ sqaron se “në rastet kur kemi fëmijë të dëmtuar nga vepra penale, puna e punonjësve të policisë bëhet akoma më e vështirë, si në dokumentimin ligjor të veprës penale që ka ndodhur ashtu edhe në referimin e të dëmtuarit të mitur në hallkat e tjera të institucioneve që ofrojnë shërbime për këta të mitur. Aktualisht mungon një sistem referimi i cili është i domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen efikase të të miturve të dëmtuar.

Nëse i referohemi rasteve të fëmijëve në situatë rruge – vijon oficerja e policisë – që lypin apo lajnë xhamat e makinave, në Kodin Penal është shtuar neni 124/b/2² por problemet dhe vështirësitë që paraqiten në zbatimin e këtij neni janë si vijon:

- Dokumentimi ligjor i kësaj vepre penale është i vështirë pasi, nga ana objektive, krimi i *detyrimit* kryhet në ambiente të mbyllura familjare.
- Tradita apo mënyra e jetesës së familjeve të këtyre të miturve

1. Drejtorja e Policisë Tiranë

2. “Neni 124/b, Kodi Penal “Keqtrajtimi i të miturit”: Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet. Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”.

i bën ata lehtësisht të manipulueshëm nga prindërit e tyre. Ata dalin për të lypur pa qenë nevoja që prindërit t'i detyrojnë pasi edhe prindërit e tyre prej vitesh e sigurojnë jetesën kryesisht duke ushtruar lypjen.

Gjithashtu, për policinë, vështirësi paraqiten edhe në drejtim të identifikimit të fëmijëve në situatë rruge pasi një pjesë e tyre janë të paregjistruar dhe një pjesë janë të ardhur në Tiranë nga rrethet e tjera, kështu verifikimi i gjeneraliteteve të tyre të sakta paraqet vështirësi. Edhe në rastet në të cilat mund të nisat procedim penal ndaj prindërve të tyre, në praktikë dalin dy probleme:

E para, fëmijët së bashku me prindërit e tyre nuk mund të gjenden lehtë në rastet kur procedohen pasi ata shtegtojnë nga një qytet në tjetrin.

E dyta, në rast se procedohet dhe merret ndaj prindërve masa e arrestit, mbetet problem strehimi i fëmijëve të tyre pasi nuk ka asnjë institucion që t'i marrë ata përsipër". Sipas pohimeve të oficerës së policisë, problem paraqet edhe implikimi në veprimtari kriminale i një numri të konsiderueshëm të miturish të moshës nën 14 vjeç. Mungesa e një institucioni të posaçëm për këta fëmijë dhe rrjedhimisht mosdhënia nga ana e gjykatës e masës edukuese për këtë kategori të miturish (të cilët nuk kanë përgjegjësi penale) është një faktor nxitës që këta të mitur të vazhdojnë kryerjen e veprave penale, kryesisht vjedhjeve të banesave e lokaleve.

Parë në një këndvështrim përmbledhës, një nga parimet kryesore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës i sanksionuar edhe në ligjin themelor të shtetit shqiptar, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, nuk gjen aplikim në jetën e përditshme. Fëmijët e familjeve Rome, fëmijët e familjeve të varfra, fëmijët e familjeve që kanë lëvizur rishtazi drejt qendrave kryesore urbane dhe që nuk kanë dokumente identifikuese dhe sigurimi nuk trajtohen si të barabartë. Mbi ta rëndojnë paragjykimet dhe stereotipa që i përjashtojnë ose i rrezikojnë për përjashtim që në fazat e hershme të jetës. Përkundrajt një situatë të rrezikshme për këta fëmijë, mungojnë shërbimet identifikuese, referuese dhe shërbimi suplementar për të respektuar një nga të drejtat e fëmijëve.

Si konkluzion:

- Shërbimi social është shumë problematik dhe jofunksional për kategorinë e fëmijëve në situatë rruge;
- Fëmijët e kanë të pamundur të kërkojnë plotësimin e nevojave të tyre. Është shoqëria ajo që është përgjegjëse për nevojat e fëmijëve dhe ky fakt nuk merret parasysh në praktikat që përdoren në vendin tonë;
- Mekanizmat që sigurojnë të drejtat e fëmijëve për shërbime sociale mungojnë ose nuk janë efektive;
- Nuk ekziston një rrjet i plotësuar dhe i organizuar për shërbimet ndaj fëmijës;
- Nevojat për shërbime për fëmijët janë të shumta;
- Në Tiranë nevojitet zgjerimi i iniciativës për hapje të NJMF-ve në çdo njësi bashkiake

4.2.4 E drejta e lojës, kohës së lirë dhe pjesëmarrjes

Fëmijët në situatë rruge kalojnë një fëmijëri pa fëmijëri. Shumë prej tyre nuk mundin të njohin lojërat e moshës, të argëtohen, të marrin pjesë në aktivitete artistike dhe sportive. Ata janë pre e punës në rrugë, të ekspozuar ndaj ndotësve të rëndë të mjedisit (tymrat dhe gazrat e makinave), të rrezikuar nga agjentë të tjerë mjedisorë, në mungesë totale të aktiviteteve zbatimëse.

Të pyetur rreth këtij komponenti të jetës së fëmijës, disa prej profesionistëve të grupit u shprehën:

“Një pjesë e këtyre fëmijëve jetojnë në kushte të rënda, madje të rrezikshme për jetën dhe zhvillimin e tyre”.

“Këta fëmijë nuk përjetojnë aktivitetin e moshës. Lojërat dhe aktivitetet e tjera karakteristike për këtë moshë janë të paarritshme për këta fëmijë”.

“Me gjithë përpjekjet që bëhen nga qendra të ndryshme ditore (në kuadrin e projekteve të organizatave shqiptare dhe ndërkombëtare) për të mundësuar pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete sportive, artistike dhe rikrijuese, ato janë shumë pak përkundrejt nevojave të këtyre fëmijëve”.

“Shkolla bën shumë pak për të krijuar hapësira dhe nxitur aktivitete krijuese ku fëmijët në situatë rruge të mund të kenë edhe mundësinë për të shfaqur prirjet e tyre të veçanta”.

“Disa prej fëmijëve në situatë rruge, të privuar nga lojërat e moshës, i përdorin energjitë e moshës për sjellje agresive, shpeshherë edhe të rrezikshme për jetën e tyre dhe të komunitetit”.

Ky komponent i jetës së fëmijëve rezulton tejet i zbuluar. Prindërit, komuniteti, shkolla, organizatat jofitimprurëse dhe qeverisja vendore ofrojnë shumë pak ose aspak në këtë fushë.

4.2.5 E drejta e emrit dhe të drejta të tjera civile të fëmijës

Ligji për gjendjen civile ka ndryshuar rishtazi dhe ka lehtësuar deri diku procedurat për regjistrimin e fëmijëve në situatë rruge që shpesh vijnë nga familje në nevojë, familje në kushte të vështira social-ekonomike, të përjashtuara dhe të diskriminuara, me burime të kufizuara financiare dhe arsimore. Pavarësisht përmirësimeve në ligj, praktika e punës me fëmijët në situatë rruge ka nxjerrë në pah disa probleme që po i paraqesim në vazhdim sikurse janë identifikuar nga specialistët e terrenit:

“Shumë nga problemet me të cilat përballen fëmijët e rrugës por edhe shumë fëmijë të tjerë e kanë zanafillën tek dokumentacioni që përgatitet me ardhjen e tyre në jetë. Akti i lindjes që lëshohet nga shtëpia e lindjes nuk është i formalizuar. Të dhënat shpesh nuk përputhen me njëra-tjetrën. Fillon kështu problemi me regjistrimin. Një fëmijë me probleme dhe pikëpyetje në dokumentacion nuk mund të regjistrohet. Në momentin që nuk regjistrohet, fillon vargu i problemeve. Ai nuk mund të marrë shërbimin shëndetësor falas, nuk mund të përfitojë nga shërbimet sociale, nuk mund të regjistrohet në shkollë etj”.

“Për të bërë regjistrimin kërkohet plotësimi i disa kushteve që ndonjëherë është e pamundur të përmbushen nga familjarët siç mund të jetë kërkesa për të pasur një kontratë të vlefshme qiraje. Në praktikën e përditshme ndeshim, brenda një familjeje, deri në tre breza të paregjistruar për shkak të mospasjes së një kontrate banimi, të një vendi të përhershëm banimi, të dokumentacionit të lindjes etj”.

“Megjithëse Ligji për Regjistrin Civil është përmirësuar, ka ende vështirësi për fëmijët romë. Fëmijët romë e kanë të pamundur të regjistrohen si individë. Kur familja është e paregjistruar, ata mbeten të paregjistruar. Në të tilla kushte, ata mund të përfitojnë vetëm nga shërbimi për kryerjen e vaksinimit falas”.

“Shpeshherë, regjistrimi i fëmijës kushtëzohet nga pagesa e taksave vendore. Shumë nga familjet e varfra (rome dhe jo rome) nuk kanë mundësi të paguajnë taksat vendore. Anëtarët e këtyre familjeve kanë të ardhura të kufizuara, janë të papunë ose marrin pagesë papunësie (si pjesë e skemës së ndihmës ekonomike të pushtetit vendor). Në këto kushte, të ardhurat e tyre janë shumë më të ulëta sesa niveli i taksave për t’u paguar. Të gjendur përpara vështirësive të tilla, ata zgjedhin të mos regjistrojnë fëmijën e tyre!”

“Me mënyrën se si funksionon sistemi sot, regjistrimi lihet në dorë të familjes. Në fakt, institucioni duhet të jetë përgjegjës për nisjen e procedurës së regjistrimit. Kjo do të bënte që çdo familje, pavarësisht kushteve, nivelit dhe mundësive, të detyrohej të bënte regjistrimin e fëmijës duke i hapur rrugën respektimit të të drejtave dhe nevojave të fëmijës”.

5. Legjislacioni dhe fëmijët në situatë rruge

5.1 Ligji ndërkombëtar për fëmijët në situatë rruge

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo konventë është ratifikuar nga Qeveria Shqiptare më 4 Nëntor 1995, ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, Fletore Zyrtare nr. 20 Gusht 1996. Në nenin 4, Konventa ndalon punën pa dëshirë dhe punën e detyruar.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky pakt është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 Dhjetor 1966 (ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 7510, datë 08.08.1991, Fletore Zyrtare Nr. 6, Gusht 1991). Në nenin 24 thuhet se “Çdo fëmijë, pa asnjë dallim të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri apo lindje, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit”.

Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Ky pakt është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 Dhjetor 1966, ratifikuar nga Shqipëria në Gusht 1991. Pakti vendos detyrimin për shtetet ratifikuese të marrjes së masave mbrojtëse

speciale për fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe shoqëror. Në nenin 10, kërkohet që Shtetet të përcaktojnë moshën limit nën të cilën puna e fëmijëve është e ndaluar.

Karta Sociale Evropiane. Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr.8960, datë 24.10.2002 (Fletore Zyrtare Nr. 75, Dhjetor 2002). Karta Sociale Evropiane vendos veçanërisht këto detyrime për shtetet anëtare:

- të përcaktohet moshë 15 vjeçare si moshë minimale për punë;
- të ndalohet puna e fëmijëve gjatë periudhës së shkollës;
- të kufizohet kohëzgjatja e punës për personat nën moshën 16 vjeç;
- të vendoset që kohëzgjatja e pushimeve të paguara për personat nën 18 vjeç të jetë 3 javë;
- të ndalohet puna e natës për personat nën 18 vjeç;
- të vendoset kontrolli i detyruar tek mjeku për personat nën moshën 18 vjeç të cilët punësohen në vende pune të përcaktuara nga ligji.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, KDF. KDF-ja u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 Nëntor 1989 dhe është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992. Shtetet palë të kësaj konvente njohin të drejtën e arsimit bazë, të detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë shfrytëzimi.

Konventa e ILO-s Nr. 138, Për moshën minimale të pranimit në punë. Shteti shqiptar e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1999. Shtetet që ratifikojnë Konventën Nr. 138 të ILO-s duhet të marrin një sërë masash për të siguruar ndalimin e punës së fëmijëve dhe të rrisin në mënyrë progresive moshën minimale për punësimin e fëmijëve në përshtatje me zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Konventa e ILO-s Nr. 182 Për Format më të rënda të punës së fëmijëve. Ratifikuar nga Shqipëria më datë 23.04.2001, kjo konventë përcakton format më të rënda të punës së fëmijëve (shih Kapitullin

Format e Punës së Fëmijëve). Çdo shtet ratifikues i kësaj konvente duhet të marrë një sërë masash për të ndaluar çdo lloj forme të rëndë të punës së fëmijëve.

Shqipëria është shtet palë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës së OKB-së që prej Marsit të vitit 1992. Gjetjet dhe rezultatet, në aspektin ligjor, në këtë studim-raport ngrihen mbi bazën e marrjes në konsideratë të mënyrës me të cilën shteti Shqiptar dhe institucionet e tij e kanë zbatuar KDF-në në praktikë dhe të nivelit në të cilin detyrimet janë kthyer në plane veprimi konkrete për mbrojtjen e fëmijëve që jetojnë në situatë rruge nga keqtrajtimi, abuzimi dhe çdo formë shfrytëzimi ekonomik dhe seksual.

5.2 Legjislacioni shqiptar dhe fëmijët që jetojnë në situatë rruge

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në themel të legjislacionit shqiptar qëndron Kushtetuta. Neni 54 i Kushtetutës parashikon një mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga Shteti. Gjithashtu, ajo parashikon të drejtën e çdo fëmije për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë – veçanërisht nën moshën minimale për punë të fëmijëve – që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën ose zhvillimin e tij normal.

Kodi i Punës. Kodi i punës, në Nenin 11 të tij, parashikon se të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës rregullohen nga Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Si rrjedhim, Konventat e ratifikuara nga Shqipëria mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse nuk kërkojnë nxjerrjen e një ligji të posaçëm¹.

Kodi i Punës trajton, nëpërmjet dispozitave të veçanta, çështjet e punësimit si ndalimin e punës së detyrueshme dhe detyrimin e punëdhënësit për të respektuar punëmarrësin, përfshirë këtu dhe kujdesin për shëndetin. Kodi i Punës nuk ka ndonjë parashikim të veçantë

1. Puna e Fëmijëve dhe Legjislacioni Shqiptar, studim i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, Korrik 2005

lidhur me punën e detyrueshme të të miturve. Në nenin 98, Kodi i Punës përcakton moshën 16-vjeçare si moshën minimale të pranimit në punë. Ky përcaktim është në përputhje me Konventën Nr. 138 të ILO-s. Gjithashtu, në Kodin e Punës lejohet punësimi i fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare por vetëm në punë të lehta dhe në periudhën e pushimeve shkollore.

Kodi i Punës përcakton se fusha e veprimtarisë së tij nuk shtrihet mbi familjen. Punët familjare që mund të kryhen nga bashkëshorti, bashkëshortja ose fëmijët përfshihen në nenin 5/c të tij por Kodi nuk parashikon rregullat e punës familjare si dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve që punojnë. Për sa i përket punës në shtëpi, në nenin 15 të Kodit të Punës parashikohet se punëmarrësi që punon në shtëpi, gëzon të njëjtat të drejta si dhe punëmarrësi që punon në një sipërmarrje. Por, përsëri, këtu nuk është përmendur mbrojtja e veçantë në rastet kur fëmijët punojnë në shtëpi.

Kodi i Familjes. Kodi i Familjes, i miratuar nga Parlamenti shqiptar, hyri në fuqi në 21 Dhjetor 2003 dhe nisi të zbatohet në Janar 2004. Përgatitja e Kodit të Familjes, ndonëse zgjati për një periudhë gjashtëvjeçare, nuk solli ndonjë trajtim të veçantë të fëmijës, me gjithë përpjekjet e shoqërisë civile që Kodi të bënte një trajtim dhe mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijës në familje. Sidoqoftë, Kodi i Familjes përfshin disa koncepte të reja një ndër të cilat është “Përgjegjësia Prindërore”. Përpos detyrimit për ushqim dhe përkujdesje, amësisë dhe atësisë, Kodi jep një sërë përkufizimesh një ndër të cilët është edhe ai i “përgjegjësia prindërore” e cila përkufizohet në nenin 215. Sipas Kodit, përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij. Neni 215 i Kodit, teksta flet për detyrimet prindërore, nuk kërkon nga prindërit respektimin e të drejtave të fëmijës bile, në njëfarë mënyre, i kufizon ato vetëm tek mirëqenia emocionale, sociale dhe materiale, duke lënë të zbuluar mirëqenien e tij fizike.

Kodi Penal (1995) nuk përmban një kapitull specifik për krimet kundër fëmijëve dhe dënimin e tyre por e shtrin veprimin e tij ndaj tyre në një sërë kapitujsh dhe nenesh të cilat, sidoqoftë, ende lënë boshllëqe për

sa i përket mbrojtjes adekuate të fëmijëve nga krimet apo kundërvajtjet penale. Në janar 2008, Kodi u amendua në disa nene¹ për të zgjeruar veprimin e tij për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi. Këtu përfshihet edhe neni 124 që kishte si qëllim përfshirjen në Kod të veprës penale të abuzimit me fëmijën. Paragrafi i ri (b) i Nenit thotë se “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet”. Në pranverë të vitit 2012, Kodit Penal iu bënë disa shtesa dhe rregullime një ndër të cilat preku edhe nenin 124 në të cilin u zgjerua lista e personave përgjegjës.

Ligji për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore² është një ndër ligjet më të rëndësishme për mirëqenien dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe familjeve në situata të vështira, përfshirë ato në situata të jetesës në rrugë apo situata të tjera ekstreme. Ligji ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë nevojat e tyre jetike.

Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës³, në nenin 5, e përcakton në këtë mënyrë parimin e mosdiskriminimit: Mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke garantuar barazinë dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinion tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij dhe eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

1. Ligji nr. 9859, datë 21.1.2008 “Mbi disa ndryshime dhe amendime te Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”

2. Ligj Nr. 9355, datw 10.03.2005

3. Ligj Nr. 10 347, datë 4.11.2010

5.3 Problematika e zbatimit të legjislacionit për fëmijët në situatë rruge

5.3.1 Ligji penal ndalon shfrytëzimin e fëmijës

Një fëmijë që ndodhet në situatë rruge gjendet, në shumë aspekte, i pambrojtur dhe mirëqenia e tij fizike, mendore, emocionale, shëndetësore dhe sociale vihet në rrezik në çdo moment. Procesi i shkeljes së të drejtave të fëmijës dhe vënies së tij në rrezik fillon që në momentin kur “gatuhet” dalja e tij në rrugë pasi vendimi nuk merret nga fëmija por nga një person që është ose prind ose kujdestar ligjor i tij. Kështu pra, vendimi merret nga ata persona që kanë për detyrë të zbatojnë si ligjin e brendshëm ashtu edhe ligjin ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijës. Ligjet në fjalë, nga ana tjetër, detyrojnë institucionet publike, vendore dhe qendrore, që të asistojnë çdo fëmijë që, për shkaqe nga më të ndryshmet, mund të vihet në situatë rreziku dhe ndërkohë të kërkojnë marrjen e masave ndaj shkelësve të ligjit.

Dalja e një fëmije në rrugë nuk është e ndaluar nga ligji por nxjerrja e fëmijës në rrugë për qëllime përfitimi është. Personi apo personat që nxjerrin një fëmijë në rrugë, pavarësisht lidhjes apo statusit që ata kanë në lidhje me të, kanë “*mens rea*” (paramendimin) për ta shfrytëzuar atë për përfitim. Në këtë aspekt, personi që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale (prindi, kujdestari ligjor apo shfrytëzuesi i fëmijës) synon të arrijë pasojën e veprimeve të tij/saj kur parashikon se veprimet do të sjellin një rezultat të dëshiruar i cili në rastin konkret janë përfitimet ekonomike apo financiare nga shfrytëzimi i imazhit apo punës së fëmijës.

Konventa Nr. 138 e ILO-s¹ u miratua nga Shqipëria në 2 Gusht 2001 dhe detyrimet e saj shtrihen mbi të gjitha Kodet dhe ligjet që kanë lidhje me fëmijët apo punën e fëmijëve. Në Nenin 3, paragrafi 3, të saj thuhet: “*puna e fëmijëve, pavarësisht nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhet, mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve*”.

Neni 124/b i Kodit Penal, me shtesat që iu bënë në vitin 2008, parashikon ndëshkimin për shfrytëzim të fëmijës për aktivitet ekonomik.

1. Konveta Nr. 182 “Per ndalimin dhe veprimet e menjehershme per eliminimin e formave me te keqija te punes se femijve”

Ligji thotë se detyrimi i fëmijës për të punuar, për të sjellë të ardhura, për të lypur ose për të kryer veprime që mund të dëmtojnë zhvillimin e tij/saj mund të dënohet me 4 vjet burg dhe me një gjobë prej 50 mijë deri në 1 milion lekë. Kur kjo vepër penale ka shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit të fëmijës ose vdekjen e tij/saj, dënohet me 10-20 vjet burg.

Në këtë aspekt, Kodi Penal (Neni 124/b) nënkupton me “detyrim të fëmijës për të punuar” veprimet e të rriturve karshi një personi nën moshën e lejuar për punë¹ të cilat kanë si qëllim shfrytëzimin e punës së fëmijës dhe të vetë fëmijës, në kundërshtim me përgjegjësitë që ky i rritur ka ndaj fëmijës. Fëmija, për shkak të moshës dhe formimit, nuk e ka aftësinë për t’i kuptuar pasojat e veprimeve të tij dhe, si rrjedhojë, ka mungesë të përgjegjësisë penale apo civile të cilat, për këtë arsye, i janë besuar një të rrituri. Për aq kohë sa fëmija nuk i kupton pasojat dhe rëndësinë e veprimeve që mund të ndërmerren prej tij, dalja e tij në rrugë për lypje apo çdo formë tjetër përfitimi, nuk mund të jetë veçse një formë detyrimi i fëmijës për të nxjerrë të ardhura për shfrytëzuesit e tij. Nëse fëmija nuk është i detyruar, si mund të shpjegohet fakti që ai/ajo është duke lypur apo duke punuar? Nëse ky do të ishte një veprim “natyral” i çdo fëmije, atëherë të gjithë fëmijët do të ishin në rrugë duke lypur apo duke punuar.

Paqartësia e Kodit Penal, në vend që të nxiste sistemin e drejtësisë për të kërkuar mënyra të reja të zbatimit të ligjit penal – sidomos Prokurorinë si organin përgjegjës të ndjekjes penale dhe të mbrojtjes së fëmijëve nga krimi – prodhoi të kundërtën e pritshmërisë së ligjvënësit. Që nga viti 2008, kur u miratuan ndryshimet në Kodin Penal, e deri në momentin e shkrimit të këtij studimi, asnjë person nuk ishte akuzuar apo dënuar në bazë të Nenit 124/b të Kodit Penal. Mungesa e një seksioni të veçantë për krimet kundër fëmijëve në Kodin Penal krijon përshtypjen se ligji penal vazhdon të mbetet ende i paplotë dhe të mos i përgjigjet nevojave të fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje nga sjellja kriminale e shoqërisë në tërësi dhe e prindërve apo kujdestarëve ligjorë të tyre në veçanti.

1. Konventa 138 e ILO's kërkon nga shtetet palë përcaktimin e moshës minimale për punë, e cila në rastin e Shqipërisë është e përcaktuar si në Kodin e Punës, ashtu edhe në Ligjin për Sistemin Arsimor Para-universitar dhe nga VKM Nr.20, Maj 1996, “Per mbrojtjen e të miturve në punë”

Siç e thamë edhe më sipër, një fëmijë që ndodhet në situatë rruge është i pambrojtur dhe i rrezikuar që të bëhet viktimë e abuzimit, pavarësisht nëse është detyruar të dalë në rrugë apo ndodhet në rrugë për shkaqe të tjera si humbja, braktisja, largimi nga shtëpia etj. Cilado qoftë arsyeja e të qenit të fëmijës në rrugë, ligji duhet të garantojë mbrojtjen e tij.

Ligji penal, përgjithësisht, garanton mirëqenien fizike të fëmijës në aspektin e mbrojtjes si nga dhuna fizike ashtu edhe nga dhuna seksuale. Megjithatë, Kodi Penal nuk i ka kushtuar ndonjë vëmendje të posaçme dhunës emocionale ndaj fëmijës, gjë që, për zbatuesit e ligjit dhe mbrojtësit e të drejtave të fëmijëve, mund të paraqesë probleme në zbatim. Mbrojtja e fëmijës që jeton në rrugë nga dhuna emocionale nuk mund të përfshijë vetëm mbrojtjen nga mashtrimi apo kërcënimi. Ajo, në tërësinë e saj, duhet të përfshijë të gjitha format e dhunës apo abuzimit të cilat shkaktojnë pasoja tek shëndeti dhe mirëqenia mendore dhe emocionale e fëmijës. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se Kodi Penal ka nevojë të përfshijë një nen specifik për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna emocionale dhe forma të tjera të përafërta me të.

5.3.2 Ligji për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Ligjin kundër Dhunës në Familje¹. Ndonëse presupozohet që ligji mbron në mënyrë të barabartë të gjitha subjektet e tij, gjatë zbatimit të këtij ligji është venë re se mbrojtja që ai u jep anëtarëve të rritur të familjes nuk është e njëjtë me atë që ai u jep fëmijëve apo adoleshentëve. Neni 13 i Ligjit thotë se të drejtën për të kërkuar një urdhër mbrojtjeje për të miturin e kanë: a) prindi ose kujdestari i të miturit; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) të afërmit; ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale të bashkisë ose komunës ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë të cilët kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga MPÇSSHB.

1. Ligj Nr.9669, datë 18.12.2006, Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare

Ligji nuk i jep një përgjigje çështjes së përgjegjësisë prindërore, kur dhe si kufizohet apo hiqet ajo kur prindërit janë dhunuesit e fëmijës, dhe, për më tepër, nuk ndalet tek fakti se si do të administrohet procesi i vendosjes së fëmijës në një vend të sigurt, nga kush do të ndiqet ky proces, kush ka përgjegjësi ligjore për fëmijën etj. Siç shihet edhe më sipër, ligji kufizon edhe numrin e subjekteve që mund të kërkojnë urdhër mbrojtjeje për fëmijën duke lënë jashtë subjekte të cilat rastësisht mund të vihen në dijeni të dhunës ndaj fëmijës, qofshin këto institucione shtetërore ose private apo individë.

5.3.3 Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës¹, ndonëse është një ligj deklarativ në shumicën e të drejtave të fëmijëve, ndër të tjera ndalet tek të drejta si:

- Neni 18: E drejta për nivel jetese të përshtatshëm;
- Neni 19: E drejta për kujdes shëndetësor;
- Neni 20: E drejta për mbrojtje sociale;
- Neni 21: Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës;
- Neni 22: Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik;
- Neni 24: Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual;
- Neni 26: Mbrojtja e fëmijës nga tortura, dënimi, trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Ndonëse në tërësi duket se Ligji i mbron fëmijët në shtatë nga format më të rënda të shkeljes të të drejtave të tyre, në të vërtetë, Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës ka të drejtë të vendosë sanksione, sipas Nenit 40, vetëm në dy prej neneve të përmendura më sipër (Nenet 21 dhe 26). Neni 21 ka më shumë interes për studim-raportin tonë, por duhet thënë se është për të ardhur keq që Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës nuk e shtriu fushën e zbatimit të sanksioneve administrative edhe mbi nene të tjera po aq të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve siç janë Nenet 18, 19, 20 dhe 22.

1. Ligj Nr. 10347, datë 04.11.2010, Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Neni 21 i Ligjit garanton mbrojtjen e fëmijës që ndodhet në territorin shqiptar nga të gjitha format klasike të dhunës përfshirë neglizhencën, braktisjen apo shfrytëzimin. Subjekt i shkeljes së ligjit (Neni 40) mund të jetë çdo person fizik apo juridik që ndodhet i regjistruar apo ushtron veprimtari në vend, përfshirë edhe vetë prindërit e fëmijës.

Ligji nuk trajton masat që do të merren ndaj personave që neglizhojnë, shfrytëzojnë apo braktisin fëmijët – siç është rasti i fëmijëve në situatë rruge – apo procedurat që do të ndiqen për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës kur shfrytëzuesi është vetë prindi i tij. Në këtë drejtim, një sërë pyetjesh mbeten pa marrë përgjigje, ndër të tjera:

- A kanë të drejtë subjektet ankuese të përshkruara në ligj të kërkojnë apo propozojnë heqjen apo kufizimin e përgjegjësisë prindërore apo kjo e drejtë i takon vetëm Njësitve të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki dhe Komuna?
- Cili është autoriteti përgjegjës që duhet të vendosë se cilat do të jenë masat emergjente që do të zbatohen për marrjen në mbrojtje të fëmijës përpara kërkimit të urdhrin të mbrojtjes?
- Cilat janë masat emergjente që mund të zbatohen për vendosjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme?
- Kush është autoriteti që ka të drejtë të marrë nga rruga një fëmijë që ndodhet në situatë rruge apo situata të tjera emergjente?
- Kush është subjekti që kërkon ngritjen e padisë penale në gjykatë për shfrytëzim apo braktisje të fëmijës?

Mungesa e ndërlidhjes midis masave, procedurave dhe detyrimeve ligjore të legjislacionit vendas mund të çojë në moszbatimin e këtij ligji të rëndësishëm. Sidoqoftë, mbetet ende për t'u parë se si do të funksionojë zbatimi i sanksioneve të ligjit për shkak se procedurat e zbatimit të tyre, në vend që të ishin bërë pjesë e këtij ligji, janë lënë për t'u përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Një ndër aspektet e rëndësishme të Ligjit për të Drejtat e Fëmijës është edhe vendosja e sanksioneve ndaj shkelësve të neneve specifike nga subjektet e ligjit. Ndonëse për shumë ekspertë ende nuk është e qartë se pse u zgjodh një institucion shtetëror jo i pavarur për vendosjen e sanksioneve, në vend të institucionit të gjykatës, apo se pse aktet e shkeljes të të drejtave të fëmijëve përbëjnë një kundërvajtje administrative, ajo

ç'ka vlen të theksohet është fakti se Ligji 10347 i jep autoritet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të vendosë gjoba administrative ndaj subjekteve të ligjit në 11 raste shkeljesh.

Neni 37 i Ligjit 10347 përshkruan detyrat e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Në pikën 1/k të tij ligji përcakton detyrimin e Agjencisë për të vendosur gjoba ndaj subjekteve fizike dhe juridike të ligjit, ndërsa në pikën 4 të të njëjtit nen, ligji thotë: “Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ndaj shkelësve të të drejtave të fëmijëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Këshilli i Ministrave i miratoi procedurat e vendosjes së sanksioneve në datë 12 Prill 2012, ose 17 muaj që prej momentit të miratimit të ligjit¹.

Sipas Nenet 40 të Ligjit, gjobat që mund të vendosë Agjencia si kundërvajtje administrative variojnë nga 30,000 në 80,000 Lekë për personat fizikë dhe nga 60,000 në 120,000 Lekë për personat juridikë. Neni 40 po ashtu vendos gjoba edhe për personin fizik brenda një personi juridik apo edhe për persona që ushtojnë një funksion publik. Nuk është e qartë se pse ligjvënësi nuk ia la në dorë gjykatës apo sistemit të drejtësisë në tërësi vendosjen e gjobave apo sanksioneve të tjera ndaj shkelësve të këtij ligji. Neni 40 e kthen Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nga një monitoruese e menaxhuese të rasteve të fëmijëve në një “gjykatëse”, dy funksione të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra dhe kërkojnë ekspertizë të gjerë juridike për t’u realizuar.

Nga ana tjetër, Ligji për Kundërvajtjet Administrative² në nenin 41 shpjegon se “Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera, të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kalojnë në Buxhetin e Shtetit...”.

Kjo do të thotë se në rastin kur një prind shfrytëzon fëmijën e tij për të lypur, ai/ajo mund të ndëshkohet me gjobë nga ana e Agjencisë deri në shumën prej 80,000 Lekësh (të reja) dhe kjo shumë shkon si një e ardhur në buxhetin e shtetit në vend që të përdoret si një mundësi financiare për të dëmshpërblyer fëmijën për shfrytëzimin që i ka ndodhur.

Fondet e gjobave të vendosura nga Agjencia nuk parashikohen të

1. Vendim Nr. 264, datë 12.04.2012, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”
1. Ligj Nr. 10 279, datë 20.5.2010 Për Kundërvajtjet Administrative

shkojnë në një fond të veçantë apo në ndonjë fond tjetër në ndihmë të fëmijëve që i kanë mbijetuar keqtrajtimit në Shqipëri.

5.3.4 Ligji për kujdesin shëndetësor në Shqipëri

Një ndër problemet më të mëdha që ndeshin ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve sociale në vend dhe vetë fëmijët që jetojnë në situatë rruge janë shërbimet shëndetësore.

Ndonëse Shqipëria deklaron se ka mbulim universal me shërbime mjekësore bazë, në realitet këto shërbime nuk ofrohen falas gjë që bie ndesh me praktikën e përgjithshme të vendeve fqinje dhe të atyre Evropiane në përgjithësi. Gjithashtu, kjo bie ndesh edhe me parimet kushtetuese të garantimit të mirëqenies sociale dhe shëndetësore të qytetarëve shqiptarë.

Ka disa ligje që rregullojnë shërbimet shëndetësore në Shqipëri. Ndër më kryesorët është Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Shqipëri¹. Neni 2 i këtij ligji, i cili flet për parimet e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, thotë në dy paragrafë të tij: “a) e drejta për kujdes shëndetësor, një e drejtë themelore e individit; b) garantimi i të drejtave të barabarta në kujdesin shëndetësor, bazuar në mosdiskriminim;” Ndërsa në Nenin 3 të tij, paragrafi 3, thuhet: “Kujdesi shëndetësor është tërësia e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjës shëndetësorë dhe shtetas, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme fizike, mendore dhe sociale të shtetasve”.

Ligji nuk paraqet ndonjë qasje karshi rregullave dhe procedurave që duhet të ndjekin njerëzit e varfër, të papunë, të braktisur apo që jetojnë në rrugë për të marrë kujdes shëndetësor falas². Ligji shpjegon mënyrat e financimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Neni 8 përcakton se kujdesi shëndetësor financohet nga: a) Buxheti i Shtetit; b) sigurimet shëndetësore të detyrueshme dhe vullnetare; c) sigurimet shëndetësore private; ç) pagesat e drejtpërdrejta.

1. Ligj Nr.10 I 07, Datë 30.3.2009, Për Kujdesin Shëndetësor Në Republikën E Shqipërisë.

2. Neni 6, Çdo shtetas është përgjegjës për: ç) dhënien e ndihmesës në financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet kontributeve të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm dhe pagesave të drejtpërdrejta të përcaktuara.

Praktikat kufizuese të ofrimit të shërbimit dhe kujdesit mjekësor bien në kundërshtim të hapur edhe me Nenin 24 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, të ratifikuar nga Shqipëria prej 20 vjetësh tashmë. Neni 24 i KDF-së, në paragrafin e tij të parë thotë: “Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor”.

Fëmijët që jetojnë në situatë rruge janë fëmijë që jetojnë pa një kujdes prindëror dhe shpesh nuk janë të pajisur me dokumentacionin e regjistrimit të tyre. Meqenëse aksesit si në shërbimet bazë ashtu edhe në shërbimet e specializuara bëhet vetëm nëpërmjet librezës shëndetësore, ofrimi i kujdesit shëndetësor është thuajse i pamundur për këtë grup fëmijësh. Në këtë drejtim, mund të thuhet se Shqipëria nuk respekton plotësisht të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes shëndetësor pasi nuk u garanton atyre aksesin e pakushtëzuar në shërbimin mjekësor.

5.3.5 Mbrojtja dhe ndihma sociale e fëmijëve në situatë rruge

Ligji për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore¹ mbetet ende sot për sot ligji bazë që në parim garanton ndihmën dhe shërbimet shoqërore për mbrojtjen e fëmijëve që vijnë nga situata të vështira në jetën e tyre, qofshin këto të lidhura me aspektin ekonomik apo me nevojën e këtyre fëmijëve për shërbime specifike.

i. Vështrim i përgjithshëm mbi ligjin 9355

Në analizën e Ligjit 9355 studiuësit janë ndalur vetëm në studimin e aspekteve të përgjithshme të ligjit, fushën e zbatimit të tij, mbrojtjen që ofron për fëmijët që jetojnë në situatë rruge dhe familjet e tyre,

1. Ligj Nr. 9355, date 10.3.2005 “PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE” i azhurnuar me: Ligjin nr.9602, datë 28.07.2006; Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009; Ligjin nr. 10 252, datë 11.3.2010; Ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011

problemet që mund të ketë ndeshur ligji në zbatimin e tij si dhe mangësitë që mund të ketë ky ligj e që ndikojnë në mosofrimin e shërbimeve dhe ndihmës shoqërore për fëmijët në rrezik dhe në nevojë. Nuk është qëllim i këtij studim-raporti të vrojtojë se si ka funksionuar sistemi, cilat janë kostot financiare dhe si kanë ndikuar aspektet buxhetore në ofrimin apo mosofrimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore.

Sidoqoftë, në një vështrim të përgjithshëm, mund të thuhet se Ligji 9355 është një ligj që e shtrin fushën e tij të zbatimit në një sërë drejtimesh që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionet e pushtetit vendor dhe atij qendror, ofrimin e shërbimeve dhe ndihmën për njerëzit në kushte të vështira ekonomike, sanksionet administrative, organizimin dhe shpërndarjen e shërbimofruesve, monitorimin e tyre etj. Në një kohë që ligji ka një fushë kaq të gjerë dhe efekte të mëdha rregulluese në nivel shtetëror dhe shoqëror, do të kishte qenë e këshillueshme që zbatimi i tij të mos mbështetej në shumicën e rasteve në VKM por të ishte zhvilluar ky ligj më tej me kapituj e nënkapituj të cilët do të ndihmonin ofrimin e garancive të mëtejshme për shërbime dhe ndihmë shoqërore.

Qasja që ka ligji përkundrejt ofrimit të shërbimeve, ndonëse në dukje është proaktive, në të vërtetë rezulton të jetë e kundërta. Roli i institucioneve publike (bashki/komunë/qark) që kanë për detyrë funksionale të ofrojnë ndihmën dhe shërbimet shoqërore është “të presin” që qytetari të vijë të kërkojë ndihmë pranë tyre, ndërkohë që qasja këtu duhet të ishte e dykrahshme. Sigurisht që çdo qytetar në nevojë apo në situatë të vështirë, për të kapërcyer gjendjen në të cilën ndodhet, ka nevojë për dorën e ndihmës së shtetit dhe të shoqërisë. Por, nga ana tjetër, edhe institucionet e shërbimit social në bashki dhe komuna nuk duhet të kthehen në “zyra pritjeje”. Ato duhet të jenë, së bashku me shërbimofruesit publikë dhe privatë, sa më pranë jetës së komuniteteve lokale, duke identifikuar të gjitha familjet dhe fëmijët në nevojë dhe fëmijët në situata të vështira, rreziku, abuzimi apo emergjence.

Roli “pritës” i institucioneve vendore të shërbimit social del në pah sidomos kur bëhet fjalë për plotësimin e dokumentacionit. Sipas Nenit 20 të Ligjit, plotësimi i dokumentacionit për kërkimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore duhet të bëhet nga shërbimkërkuesi. Me pak fjalë, kjo do të thotë se një person në situatë ekonomike ekstreme, që nuk ka mundësi financiare të përdorë transportin publik apo të paguajë

shërbimet e noterit, të cilat nuk janë parashikuar në asnjë ligj që të jepen falas e që për më tepër janë të kushtueshme, duhet të shkojë një nga një tek të gjitha zyrat e shtetit shqiptar e më pas të noterizojë në disa kopje dokumentacionin e kërkuar. Nga eksperiencia e OJF-ve që punojnë me raste të tilla, një person në varfëri ekstreme nuk e ka mundësinë që t'i plotësojë të gjitha këto kërkesa, sado të thjeshta që ato mund të duken në letër. Shkak për këtë, me sa duket, është mungesa e procedurave të shkruara të shkëmbimit të dokumenteve zyrtare që përmbajnë të dhëna personale, të cilat do të ndihmonin në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga ligji.

Do të ishte e përshtatshme që të ishte administratori social në bashki dhe komunë personi që t'i kërkonte institucioneve të tjera, publike dhe private, vënien në dispozicion të tij të të gjithë dokumentacionit që ligji kërkon që të plotësohet. Është një nonsens juridik që shkëmbimi i dokumentacionit midis institucioneve të bëhet vetëm dhe nëpërmjet një individi privat, sado në nevojë që të jetë ai/ajo. Në këtë aspekt, ligji nuk e zgjidh çështjen e shkëmbimit të dokumentacionit zyrtar dhe, për më tepër, ai lë mundësi që marrja dhe transferimi i këtij dokumentacioni të shërbejnë si bazë për mashtrime apo edhe përfitime të paligjshme nga personat që administrojnë këto procese dhe dokumente.

Skema e ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, ndonëse përpiket që të jetë një skemë sa më horizontale duke respektuar autonominë e pushtetit vendor në tërësinë e tij, ka tendencën që të mos funksionojë. Ndonëse skema përcakton thujtë qartë të gjithë hapat që duhet të ndiqen për ofrimin e shërbimeve, eksperiencia 6-vjeçare e zbatimit të ligjit ka treguar se, nëse nuk zgjidhen disa çështje thelbësore të saj si: a) buxhetimi; b) tenderimi (prokurimi publik) i shërbimeve shoqërore dhe c) strukturimi i funksionimit të skemës së shërbimit, qëllimi i ligjit për të garantuar ndihmë dhe mbështetje për të gjithë qytetarët mund të jetë i pamundur për t'u arritur.

Ndonëse duket sikur ligji garanton parimin e mosdiskriminimit, ai në të vërtetë përjashton një pjesë të shërbimkërkuarve nga përfitimi prej zbatimit të tij. Fakti që një shërbimkërkuar nuk mund të jetë vetë fëmija (sipas Nenit 6 të Ligjit fëmija është vetëm përfitues i shërbimeve) por vetëm kryetari i familjes është një tregues i këtij argumenti dhe një faktor që kufizon ofrimin e shërbimeve tek ata që më së shumti kanë nevojë

për to. Po ashtu, ligji thotë se, familjet apo personat që janë përfitues të ndihmës ekonomike, nuk mund të përfitojnë shërbime shoqërore dhe anasjelltas, ndërkohë që, nga eksperiencia, dihet tashmë se shumë prej familjeve të varfra kanë nevojë si për ndihmë ekonomike ashtu edhe për shërbime shoqërore pa pagesë.

Në të njëjtën kohë, ligji kërkon që çdo person që ka nevojë për ndihmë dhe shërbime shoqërore, t'i drejtohet me shkrim strukturës përkatëse në Bashki dhe Komunë (Neni 20 i Ligjit) ndërkohë që, një pjesë e personave që janë në situata të vështira, mund të mos kenë arsimimin e duhur apo kushtet e përshtatshme financiare për të shkruar qoftë edhe një kërkesë të thjeshtë dhe, mbi të gjitha, për të plotësuar dokumentacionin që shpesh kërkohet të jetë i noterizuar. Ligji nuk parashikon se si personat analfabetë apo në varfëri ekstreme mund të kërkojnë ndihmë, se si mund të plotësohet dokumentacioni kur ai është përkundrajt pagesës, dhe, për më tepër, ai nuk u jep të drejtë as OJF-ve që t'i drejtohen bashkive dhe komunave për të kërkuar ndihmë falas në emër të një apo disa personave të varfër dhe në nevojë për ndihmë dhe shërbime.

Ankesa për vendimmarrjen e padrejtë, sipas Nenit 25 të Ligjit, bëhet në Gjykatë. Duke pasur parasysh kostot financiare që ka ngritja e një padie (rreth 12,000 lekë të reja) dhe situatën e vështirë ekonomike të shërbimkërkuarit, shihet qartë se ligji i kufizon familjeve të varfra një të drejtë bazë të njeriut, siç është e drejta për t'u ankuar për një vendim të padrejtë, që në hapin fillestar të ankesës. Në parim, një kufizim i tillë mund të përbëjë shkak për ankesë në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas ligjit, ofrimi i shërbimeve shoqërore nga shërbimofruesit publikë apo privatë bëhet vetëm me autorizimin e Administratorit shoqëror në bashki dhe komunë e jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga shërbimkërkuari (Neni 31 i Ligjit). Kjo përbën një tjetër kufizim të të drejtës së çdo shtetasi për të pasur akses në shërbimet publike në çdo moment që ai ka nevojë për to.

Një shembull konkret që mund sjellim në këtë këndvështrim mund të ishte rasti i mëposhtëm:

“Nëna e familjes A, e cila është pjesëtare e rritur e një familjeje me shumë fëmijë, kërkon që 4 prej fëmijëve të saj t'i vendosë për trajtim ditor në qendrën komunitare ditore të hapur nga Bashkia e Tiranës dhe të financuar nga buxheti

i saj! meqë ajo ofron edhe ushqim falas. Nëna e fëmijëve paraqitet në Qendër për të kërkuar ndihmë por ligji kërkon që fëmijët të pranohen në këtë qendër vetëm me autorizimin e Administratorit shoqëror pranë minibashkisë përkatëse. Nëna paraqitet pranë minibashkisë dhe Administratori i kërkon nënës së fëmijëve që përpara tij të paraqitet kryefamiljari (babai), i cili në fakt është konsumues i rregullt i alkoolit dhe paraqitet në shtëpi vetëm vonë në darkë, shpesh i dehur dhe i dhunshëm. E vendosur në këto kushte, nëna, çdo mëngjes, del në një nga rrugët kryesore të Tiranës për të lypur së bashku me fëmijët e saj. Këto janë situatat të cilave jo vetëm ligjvënësi por kryesisht zbatuesit e ligjit duhet t'i japin zgjidhje.

Nëse ligji nuk është i qartë apo ngre shumë pikëpyetje në interpretimin e procedurave, atëherë zbatimi i tij shpesh mund të hasë në vështirësi. Qëllimi i një ligji të tillë duhet të jetë lehtësimi i jetës së personave që tashmë janë në kushte ekstreme të dhunës apo varfërisë e t'u gjendet pranë atyre, për t'i ndihmuar që mirëqenia e tyre relative të mos shkatërrohet por, nëpërmjet ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, të stabilizohet dhe më pas të ngrihet në një shkallë të tillë që familja të jetë e aftë të përmbushë qëllimet e saj të kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe pjesëtarëve të tjerë të saj.

ii. Ligji 9355 dhe garancitë për ndihmë dhe shërbime shoqërore

Siç edhe u theksua më sipër, ky ligj sot për sot është i vetmi ligj bazë që garanton ndihmën dhe shërbimet shoqërore për mbrojtjen e fëmijëve. Si i tillë, analiza e tij është e rëndësishme. Ajo na ndihmon të kuptojmë pse kaq shumë fëmijë që jetojnë në situatë rruge nuk kanë përfutuar thujtë asnjëherë nga zbatimi i këtij ligji.

Neni I i Ligjit ndalet tek qëllimet e përgjithshme të tij duke u shprehur në mënyrë të veçantë për sa më poshtë. Qëllimi i ligjit është që:

- 1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave jetike*

I. Kjo qendër ofron shërbime komunitare për fëmijët në nevojë me financim nga Bashkia Tiranë

bazë, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

- 2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.*

Ligji, në Nenet 10, 12 dhe 13 të tij, parashikon se çdo person që nuk mund të sigurojë nevojat jetike bazë, mund të përfitojë këto lloje ndihme: a) Ndihmë ekonomike; b) Përfitime në natyrë (të mira materiale, por jo monetare); c) shërbime shoqërore të ndara në: shërbime të përkujdesit shoqëror dhe shërbime të përkujdesit shoqëror dhe shëndetësor. d) Vendosjen në familje kujdestare. Siç shihet, gama e shërbimeve që garantohej nga ligji është e gjerë, në kontrast me gamën e shërbimeve që ofrohen realisht në nivelin lokal dhe atë qendror.

Neni 17 përcakton se cilat janë autoritetet përgjegjëse për ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore si më poshtë:

- 1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në institucionet rezidenciale, ditore ose në shtëpi për grupet në nevojë.
Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore.*
 - Shërbimi Social Shtetëror administron shërbimet shoqërore për individët në nivel kombëtar.*
 - Bashkitë ose komunat administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individët që janë banorë të atij qyteti apo komune.*
 - Qarku administron shërbimet kur ato ofrohen për individë që u përkasin disa njësive vendore në atë qark.*
- 2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror privat përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi të financuara privatisht.*

Neni 19 përcakton kriteret e përfitimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga qytetarët për t'i përfituar ato. Ndihma ekonomike e plotë i ofrohet atyre personave që

nuk përfitojnë nga: a) veprimtaria ekonomike; b) programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore; c) kapitali; ç) pjesëtarët e familjes që janë në emigracion. Ndërkohë që ndihma ekonomike është e pjesshme kur familja ka të ardhura të pamjaftueshme nga: a) toka; b) bagëtia etj; c) pensionet dhe të ardhura të tjera.

Me shtesat që iu bënë ligjit në Mars 2011, për herë të parë, parashikohen një sërë kategorish të reja përfituesish të cilët përfitojnë nga ndihma dhe shërbimet shoqërore kur:

- a) nuk kanë kryefamiljarë, për arsye të vdekjes së të dy prindërve të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;
- b) njëri prej prindërve është duke vuajtur dënimin me burgim, për vepra penale, me vendim gjyqate të formës së prerë, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;
- c) njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjyqate, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, në gjendjen familjare të të cilit ka fëmijë;
- ç) kanë si kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara, fizike e mendore, i verbër, paraplegjik/tetraplegjik ose invalid pune, dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;
- d) kanë si kryefamiljar nënën, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;
- dh) kanë si kryefamiljar një pjesëtar të familjes që është mbi moshë pune dhe, kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë dhe persona mbi moshë pune, pavarësisht nga të ardhurat, nga pensioni apo toka;
- e) janë familje të mbyllura në shtëpi, si pasojë e gjakmarrjes;
- ë) janë familje që i përkasin komunitetit rom;
- f) janë familje nën nivelin e varfërisë, sipas listës së përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse.

Sipas Nenit 20, ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj. Këshilli i Bashkisë dhe Komunës përcakton se cilat janë familjet që do të përfitojnë nga ndihma ekonomike pas vlerësimit të dhënë nga administratori social i institucionit. Kërkesa për ndihmë ekonomike

bëhet nga kryetari i familjes¹, apo nga secili prej bashkëshortëve nëse ata kanë hapur procedurat e divorcit, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes.

iii. Rehabilitimi dhe integrimi i fëmijëve në situatë rruge

Ligji 9355 nuk ndalet tek grupet specifike të fëmijëve dhe mbështetja përkatëse pasi i konsideron të gjithë fëmijët që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe shërbime shoqërore si një grup të vetëm. Ndoshta do të ishte e udhës që shërbimet specifike për fëmijët, sidomos për ata që i kanë mbijetuar situatave ekstreme të abuzimit apo shfrytëzimit, të gjenin një trajtim specifik të mënyrës së organizimit dhe ofrimit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel qarku apo bashkie.

Skema e funksionimit të ligjit e vendos thujtë të tërë barrën e ofrimit të shërbimeve sociale tek bashkitë dhe komunat dhe kërkon nga ato ngritjen e zyrave specifike që do të merren me ofrimin e shërbimeve (Neni 30). Sidoqoftë, që nga viti 2005 e në deri me sot, me përjashtim të bashkive më të mëdha, thujtë asnjë nga bashkitë e komunat e tjera në Shqipëri nuk ka zyra specifike për ofrimin e shërbimeve sociale por vetëm një apo disa persona që, ndër të tjera, mbulojnë edhe detyrimet e zbatimit të këtij ligji.

Sipas Nenit 29 të Ligjit, roli i Këshillit të bashkisë apo komunës (pushtetit vendor) në ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore është si vijon:

- 1. Harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në burimet, nevojat dhe përparësitë vendore.*
- 2. Miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e përparësive vendore.*
- 3. Merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:*

1. Kjo në vetvete është një stereotip gjinor, pasi përcakton në mënyrë ligjore rolet e mashkullit dhe femrës në familje. Ky përkufizim mund të bjerë ndesh me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve, të kryera nga administratori shoqëror;
- b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Siç shihet edhe nga të tre paragrafët e shkëputur nga neni 29, pushteti vendor luan një rol vendimtar në përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që duhen ofruar në territorin e tyre. Deri në momentin e përfundimit të këtij studim-raporti, vetëm 6 qytete të mëdha kishin përgatitur planet e tyre të zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

iv. Largimi nga rruga i fëmijëve që jetojnë në situatë rruge

Fëmijët që jetojnë në situatë rruge, në shumicën e rasteve, ushtrojnë profesionin e lypjes dhe, në raste më të rralla, atë të shitjes me pakicë. Fenomeni është gjerësisht i përhapur në Tiranë dhe Durrës për shkak se të dyja qytetet kanë numër popullsie dhe të ardhura më të larta se qytetet e tjera. Sidoqoftë, fenomeni është gjerësisht i përhapur në përgjithësi edhe për shkak se ligji vendas nuk e ndalon lypjen as të fëmijëve dhe as të të rriturve.

Shoqëria civile reagoi kur, disa muaj më parë, pa të drejtë, strukturat e policisë nisën një fushatë të heqjes dhe largimit të lypësve nga qendra e Tiranës. Për shkak të presionit policor, pjesa më e madhe e fëmijëve që lypnin në rrugë u larguan nga qendra e kryeqytetit për të lypur në rrugët kryesore të periferisë. Nga informacioni i grumbulluar, nuk rezulton që Policia dhe Prokuroria të kenë arrestuar apo ndjekur penalisht ndonjë person apo familjar për shfrytëzim të fëmijëve për lypje.

Qoftë ligji penal qoftë ligje të tjera në Shqipëri nuk e ndalojnë lypjen si fenomen, përfshirë edhe lypjen e fëmijëve. Në këtë drejtim, një ndër rekomandimet e këtij studim-raporti do të ishte kriminalizimi i shfrytëzimit të fëmijëve për lypje apo edhe i formave të tjera të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve si një mundësi për të ndëshkuar të gjithë personat që kërkojnë të nxjerrin përfitime dhe të ardhura nga puna e fëmijëve. Nga ana ligjore, kjo do të duhet të shoqërohet me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse për heqjen ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, nëse shfrytëzuesit e fëmijëve janë prindërit, si dhe me kërkesën për vendosjen e fëmijës në qendra rezidenciale apo në familje kujdestare, duke pasur gjithmonë

parasysh zgjidhjen në interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji 9355 nuk trajton në ndonjë mënyrë të veçantë se si duhet të veprohet për heqjen/kufizimin e përgjegjësisë prindërore dhe cilat janë procedurat që duhet të ndiqen. Për më tepër, ndër detyrat funksionale të Administratorit Shoqëror në bashki dhe komunë nuk parashikohet e drejta e administratorit për t'iu drejtuar gjykatës për heqjen e përgjegjësisë prindërore prindërve që nuk janë të aftë të rrisin dhe të garantojnë mirëqenien e fëmijëve të tyre pavarësisht ndihmës ekonomike apo shoqërore që mund t'u jetë dhënë. Shteti shqiptar ka për detyrë të mbrojë çdo fëmijë nga abuzimi, keqtrajtimi, neglizhenca dhe shfrytëzimi. Në këtë aspekt, e drejta e jetës dhe sigurisë së fëmijës është një e drejtë prioritare. Të pasurit e një fëmije nuk është thjesht një e drejtë, është më së shumti një përgjegjësi. Fakti që shpesh fëmijët që ndodhen në situata ekstreme të shfrytëzimit dhe abuzimit për shkak të jetesës në rrugë janë lënë nën kujdesin e prindërve apo familjeve shfrytëzuese është tregues se shërbimet sociale dhe ato të zbatimit të ligjit i kanë dhënë prioritet të drejtave të prindërve dhe jo atyre të fëmijëve, ndërkohë që është detyrim i tyre parësor të garantojnë mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së fëmijës në çdo moment.

Kjo mangësi e ligjit e ka kthyer administratorin shoqëror në shumicën e rasteve në një administrator të dokumentacionit dhe jo të shërbimeve të vërteta shoqërore.

Neni 31 (Ligji Nr. 9355)

Administratorët shoqërorë në bashki ose komuna kanë për detyrë:

- a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;
- c) të propozojnë në këshillin e bashkisë ose komunës familjet në nevojë, për të përfituar ndihmë ekonomike;

- ç) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- d) të marrin pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuar dhe personave që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;
- dh) të llogarisin dhe të propozojnë për miratim në seksionin e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bashkisë ose komunës masën e ndihmës ekonomike;
- e) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e qeverisjes vendore;
- ë) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve vendore dhe rajonale në mbështetje të personave në nevojë;
- f) të vlerësojnë nevojat e individëve ose familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe vendore, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, të përgatisin dokumentacionin dhe propozimet për miratim në këshillin e bashkisë ose komunës;
- g) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- gj) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë ose komunës.

v. Shpërndarja e shërbimeve shoqërore, buxhetimi dhe prokurimi publik i tyre

Ligji 9355 përmban një rregullim juridik që, në kushtet e sotme, duket si i pakuptimtë në lidhje me ushtrimin e detyrave të administratorit shoqëror. Siç shihet në Nenin 31 të Ligjit, një ndër detyrimet funksionale të administratorit është identifikimi i nevojave të individëve për shërbime të kujdesit shoqëror (sipas përkufizimeve të neneve 12 dhe 13 në ligj),

përgatitja e dokumentacionit përkatës për individët dhe grumbullimi i informacionit për rrjetet e shërbimeve publike dhe private në territorin përkatës.

Në vijim të logjikës së nenit dhe vetë ligjit, me të drejtë lindin disa pyetje: Ku ndodhen këto shërbime publike? Si blihen shërbimet shoqërore private? Cila është gama, niveli dhe shtrirja e tyre? Mungesa e një harte të shërbimeve dhe e një banke të dhënash mbi to e bën të vështirë dhënien e përgjigjeve këtyre pyetjeve. Sidoqoftë, nga informacionet që na janë vënë në dispozicion, mësojmë se, me përjashtim të shërbimeve shoqërore rezidenciale për fëmijët e trafikuar dhe të një numri të vogël qendrash private ditore për fëmijët, Shqipëria nuk ka një sistem adekuat të mbrojtjes shoqërore dhe shpërndarjes së shërbimeve sociale. Atëherë, pse duhet që ligji t'i caktojë një sërë përgjegjësish një zyrtari publik i cili, për shkak të mungesës së shërbimeve (në kohën që është miratuar ligji dhe në vijim), e ka të pamundur t'i plotësojë ato?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje gjendet në një sërë nenesh të Ligjit 9355. Në nenin 18 (para. 2/3) thuhet:

- *Shërbimet e përkuqdesit shoqëror publik, që financohen me fondet e buxhetit qendror apo vendor prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.*
- *Organet e pushtetit vendor lidhin kontratë me personat juridikë privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.*

Studiuesit nuk janë në dijeni që ndonjë nga organet e pushtetit vendor, në nivel qarku, bashkie apo komune, të ketë organizuar ndonjëherë, gjatë këtyre 6 viteve të zbatimit të ligjit, prokurime publike për blerjen (prokurimin) e shërbimeve shoqërore tek ofruesit privatë, me përjashtim të një Bashkie, asaj të Elbasanit. Nga ana tjetër, thuajse të gjitha shërbimet shoqërore sot ofrohen nga sektori i shoqërisë civile dhe organizatat jofitimprurëse (ofrues privatë) dhe vetëm një pjesë e vogël nga ofruesit publikë.

Ligji, sipas skemës që ngre për shpërndarjen e shërbimeve, nuk krijon asnjë kufizim për ofrimin e shërbimeve sociale, si në nivel vendor ashtu edhe në nivel kombëtar, dhe as për prokurimin e tyre kur e kërkon nevoja. E megjithatë, qindra fëmijë në situatë rruge nuk kanë qenë ndonjëherë

përfitues të shërbimeve apo të ndihmës ekonomike.

Dy mund të jenë arsytet për këtë:

Arsyeja e parë është aspekti buxhetor. Një nga kritikantët e mëdha që mund t'i bëhet ligjit është kufizimi i ndihmës dhe shërbimeve shoqërore nga buxheti i pamjaftueshëm i planifikuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit dhe, më tej akoma, në buxhetin e bashkive dhe komunave. Ndonëse shoqëria civile ka kërkuar me forcë vendosjen në ligj të një dshemeje minimale dhe një tavani maksimal të ndihmës që mund të përfitojë një familje e varfër, kjo gjë asnjëherë nuk ka ndodhur. Edhe me ndryshimet dhe shtesat që iu bënë ligjit në vitin 2011, kjo çështje mbeti e pazgjidhur duke e bërë më të lehtë për institucionet publike, sidomos në nivel vendor, mosplotësimin e një prej detyrimeve të objektivave sociale të shtetit shqiptar të përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Në nenin 28 dhe 29 të Ligjit përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore për buxhetimin dhe miratimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, ndërsa në Nenin 37 shpjegohen qartë burimet e financimit të shërbimeve:

Neni 37

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike në nivel qarku, bashkie ose komune, në institucionet rezidenciale, në qendrat ditore, në familje ose shërbime të lëvizshme në komunitet përbëhen nga:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti qendror i Shtetit;
- b) fondet e caktuara nga taksat dhe tarifat vendore;
- c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë ose komunës;
- ç) kontributet e përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;
- d) dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni.

Arsyeja e dytë, sipas ekspertëve, mund të jetë mungesa e një historiku të ofrimit të shërbimeve sociale në periudhën komuniste dhe përpara saj. Shqipëria nuk trashëgoi asnjëherë një shtet të mirëqenies sociale. Ndonëse në dukje sistemi komunist ofronte një sërë shërbimesh, ato ishin më tepër shërbime infrastrukturore për të rregulluar mirëqenien kolektive të njerëzve dhe jo atë individuale të tyre. Varfëria ishte po aq e përhapur sa ç'ishte edhe mirëqenia relative dhe mbrojtja që ofronte sistemi (kopshte e shkolla pa pagesë, shërbime shëndetësore falas, punësim për këdo, pushime të garantuara etj.). Ky sistem nuk arriti asnjëherë të ndërtonte qendra të punës sociale, qendra komunitare apo edhe shërbime të tjera për të ndihmuar familjet dhe fëmijët në nevojë. Kur njerëzit përballeshin me probleme individuale, sidomos gratë dhe fëmijët, përjashtimi social mund të ishte po aq i ashpër sa edhe sot. "Rrjeta mbrojtëse" që sistemi komunist kishte ngritur ishte aq e hollë sa, kur ai u rrëzua, sistemi i ri politik nuk kishte një sistem apo model pune për të vijuar të ndihmonte njerëzit. Mungesa e modeleve të mirëqenies sociale – ku shteti dhe shoqëria ndihmojnë familjet dhe individët në nevojë - nuk kishte se si të mos ndikonte në lënien pa ndihmë dhe mirëqenie minimale të qindra individëve dhe familjeve anëmbanë Shqipërisë, përfshirë fëmijët.

Neni 32 i Ligjit është një ndër treguesit më të mirë të faktit që shteti shqiptar ende nuk i sheh shërbimet shoqërore si një detyrim që buron nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare por shprehet për ofrimin e tyre sipas mundësive të buxhetit të shtetit.

Neni 32

Shteti ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe forma të tjera të mbështetjes për personat në nevojë, sipas **mundësive** të Buxhetit të Shtetit.

Ligji, ndër të tjera, ngre edhe një strukturë monitoruese, siç është **Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore** (Neni 27, paragrafi 2) i cili është përgjegjës për kontrollin e veprimtarisë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komuna. Nuk është e qartë ende

nëse ky inspektorat është bërë funksional apo jo dhe cilat janë masat që ai ka marrë për ta bërë ligjin të zbatueshëm.

Siç u theksua më sipër, Ligji Nr. 9355 ka një sërë aspektesh pozitive të cilat duhen marrë në konsideratë. Në këtë këndvështrim, shoqëria civile dhe organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijët duhet të jenë më të forta në qëndrimet e tyre për të kërkuar zbatimin e të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësive që ligji i cakton si institucioneve vendore ashtu edhe atyre kombëtare.

Një ndër zhvillimet pozitive të Ligjit është edhe krijimi i **Fondit Shoqëror**. Neni 39 nuk jep shumë detaje mbi si do të funksionojë fondi por ia lë këtë të drejtë Këshillit të Ministrave. Deri në momentin e shkrimit të këtij studimi, fondi nuk ishte bërë ende aktiv dhe mbetet për t'u parë nëse ai do të bëhet funksional gjatë vitit 2011.

Neni 39

Për mbështetjen e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore krijon **Fondin Shoqëror**, i cili përbëhet nga:

- a) një pjesë e fondeve të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë;
- c) të ardhurat e tjera, që sigurohen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, që Republika e Shqipërisë lidh me shtetet e tjera;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

Rregullat e përdorimit të Fondit Shoqëror përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Konkluzione

6.1 Në fushën sociale

6.1.1 Në fushën e shërbimeve

- Jetesa dhe kushtet e fëmijëve në situatë rruge janë tepër komplekse. Mungon një studim mbarëkombëtar mbi gjendjen dhe problemet e fëmijëve në situatë rruge;
- Politikat sociale në favor të fëmijëve në situatë rruge janë të varfra;
- Mungon një sistem i mirorganizuar dhe i koordinuar shërbimesh shoqërore për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge por edhe të fëmijëve në përgjithësi;
- Shërbimet ekzistuese janë të pamjaftueshme për të mundësuar plotësimin e nevojave që kanë fëmijët në situatë rruge; ato ofrohen kryesisht nga organizata të shoqërisë civile;
- Procedurat për marrjen e shërbimeve janë shpesh penguese;
- Strukturat e qeverisjes vendore janë apatike dhe të paangazhuara në identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në situatë rruge; ato nuk e njohin ligjin dhe përgjegjësitë e, për rrjedhojë, nuk angazhohen në bashkëpunime me aktorë të ndryshëm për të plotësuar nevojat e fëmijëve në situatë rruge;
- Sistemi i mbrojtjes sociale të fëmijëve mungon;
- Mungojnë mekanizmat e monitorimit dhe të dhënat që përcaktojnë situatën aktuale dhe progresin e bërë;
- Nevojitet hapja e njësive për mbrojtjen e fëmijëve në Tiranë në të gjitha njësitë bashkiake;

6.1.2 Në fushën e arsimit

- Përpjekjet që bëhen për përfshirjen e fëmijëve në situatë rruge në arsim janë të fragmentarizuara dhe të pakoordinuara;
- Përfshirja e fëmijëve në situatë rruge në arsim mbetet në përqindje

të vogël dhe shumë prej këtyre fëmijëve largohen nga shkolla në moshë të hershme;

- Fëmijët në situatë rruge përjetojnë forma të hapura diskriminimi nga shokët e tyre të shkollës, prindërit e fëmijëve të tjerë, por edhe nga mësuesit;
- Mësuesit nuk janë të motivuar të punojnë me fëmijët në situatë rruge dhe bëhen inkurajues (pa dashje ndonjëherë) të largimit të tyre nga shkolla;
- Mësuesit e kualifikuar nga komuniteti Rom janë në një numër shumë të vogël dhe nuk mund të bëjnë ende ndryshim;
- Fëmijët në situatë rruge shpesh kanë probleme dokumentacioni që e vështirësojnë pranimin në shkollë;
- Aktet ligjore dhe nënligjore për pajisjen me tekste dhe mjete shkollore falas nuk aplikohen dhe monitorohen rregullisht;
- Fëmijëve në situatë rruge u mohohet një shans i dytë për edukim, ndonëse kjo e drejtë është parashikuar në dokumentet politike të qeverisë;
- Fëmijët në situatë rruge kanë mundësi të kufizuara për përfshirjen në programet parashkollore;
- Mungon bashkëpunimi i shkollës me prindërit e fëmijëve në situatë rruge;

6.1.3 Në fushën e shëndetit

- Fëmijët në situatë rruge nuk mundën të marrin shërbimin shëndetësor falas, kjo për arsye se aktet nënligjore apo urdhrat e brendshëm bien ndesh me këtë të drejtë kushtetuese;
- Mungojnë politikat shëndetësore në ndihmë të këtyre fëmijëve;
- Mungojnë programet publike që sigurojnë ndërhyrjen në ndihmë të këtij grupi fëmijësh;
- Fëmijët në situatë rruge marrin vetëm vaksinimin falas, ndërkohë që gjithë shërbimi tjetër është i pamundur të arrihet prej tyre për shkak të mungesës së sigurimit shëndetësor;
- Mjekët janë të detyruar shpeshherë të ofrojnë shërbimin ndaj fëmijëve në situatë rruge në mënyrë joligjore;
- Fëmijët në situatë rruge janë të rrezikuar nga probleme të shpeshta

dhe të shumta të shëndetit për shkak të ekspozimit ndaj faktorëve kërcënues si mungesa e kujdesit për higjienën, mungesa e ushqimit, mungesa e veshmbathjes, mungesa e regjimit të pushimit si dhe ndaj faktorëve të tjerë si ndotësit e ajrit dhe infeksionet e ndryshme. Në këto kushte, nevoja e tyre për shërbim shëndetësor është shumë e madhe. Detyrimi i shtetit, në këtë rast, është të realizojë ndërhyrje emergjente.

- Fëmijët në situatë rruge nuk arrijnë të përfshihen në aktivitete të moshës; ata janë të privuar nga fëmijëria e tyre dhe shpesh i shkarkojnë energjitë duke u përfshirë në sjellje agresive;

6.1.4 Në fushën e regjistrimit të fëmijëve

- Mbetet e pazgjidhur situata e regjistrimit të fëmijëve në situatë rruge që vijnë nga familje të paregjistruara; ndonëse ka një rregullim në ligj, nevojiten mekanizma më fleksibël dhe më të aplikueshëm për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve.
- Regjistrimi i fëmijës varet nga situata e familjes; shpeshherë familjet nuk i përballojnë dot detyrimet për kryerjen e regjistrimit të fëmijës (p.sh. pagesën e taksave vendore, pajisjen me kontratë banese etj.);
- Shumë shërbime ndaj familjeve dhe fëmijëve varen nga regjistrimi dhe mungesa e tij i vë fëmijët në pozita të pabarabarta dhe diskriminuese kundrejt bashkëmoshatarëve të tyre;
- Regjistrimi mbetet përgjegjësi e familjes, ndërkohë që institucionet e qeverisjes vendore janë jashtë funksionit dhe pa asnjë përgjegjësi.

6.2 Në fushën legislative

- Shqipëria ka ende një rrugë të gjatë për të bërë në drejtim të garantimit të të drejtës së fëmijës për mbrojtje, kujdes dhe mirëqenie sociale. Legjislacioni ekzistues, ndonëse ka pasur përmirësime gjatë viteve të fundit, ende nuk i mbron tërësisht fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik apo forma të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve si puna familjare.
- Detyrimet që përcaktohen nga Kushtetuta, një sërë konventash

ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar dhe vetë kuadri ligjor shqiptar nuk janë zbatuar tërësisht nga institucionet që kanë për detyrë t'i zbatojnë ato. Si pasojë, kjo ka lënë jashtë *rrjetës mbrojtëse* të shtetit një numër të lartë fëmijësh dhe familjesh të cilët, të detyruar nga kushtet ekstreme të varfërisë, gjenden apo jetojnë në situatë rruge, e cila shpesh për fëmijët është një situatë shfrytëzimi nga ana e prindërve të tyre.

- Institucionet e zbatimit të ligjit, sidomos Prokuroria e Shtetit por edhe Policia, nuk kanë treguar forcë në zbatimin e ligjit penal, duke lënë në një situatë shfrytëzuese, abuzuese dhe pa mbrojtje qindra e mijëra fëmijë në Shqipëri.
- *Përgjegjësia prindërore* shpesh konceptohet nga institucionet e zbatimit të ligjit më shumë si një e drejtë sesa si një detyrim i prindërve përkundrejt fëmijës. Kjo ka penguar marrjen e masave institucionale kundër prindërve të cilët, jo vetëm janë të paafte të kujdesen për mirëritjen e fëmijëve por shpesh mund të jenë kthyer edhe në shfrytëzuesit e tyre të drejtpërdrejtë. Lidhur me këtë, duhet thënë se Kodi i Familjes nuk parashikon një mbrojtje të posaçme të fëmijës në situata shfrytëzuese brenda familjes.
- Ndonëse legjislacioni ka bërë përmirësime në drejtim të shtrirjes së përfitimeve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore tek një sërë kategorish të reja, përsëri një pjesë e mirë e ligjeve mbeten të pazbatuara, sidomos në nivel lokal.
- Është e studiuesve se funksionet e pushtetit lokal në drejtim të shpërndarjes së ndihmës ekonomike dhe shoqërore si dhe të organizimit të ofrimit të shërbimeve në përgjithësi asnjëherë nuk janë përmbushur sipas mënyrës së kërkuar nga ligji. Kjo përfshin si organizimin administrativ të punës së administratorëve shoqërorë në nivel lokal ashtu edhe zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me buxhetimin e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore dhe prokurimin e tyre.
- Skema e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, pavarësisht se ndihmon një numër të madh të familjeve të varfra anembanë Shqipërisë, për shkak të mënyrës me të cilën është konceptuar, nuk mund t'ia arrijë qëllimit që ligjvënësi ka përcaktuar në ligj. Për më tepër, ekziston një perceptim i përgjithshëm midis ekspertëve se

skema e ndihmës ekonomike po përdoret më shumë për të rritur bazën e përfituesve të ndihmës sesa për t'i larguar ata nga skamja, varfëria apo situatat e vështira.

- Shqipëria është një vend që nuk ka pasur ndonjë histori të mirëfilltë të ndërtimit të shërbimeve shoqërore të zhvilluara apo të shtetit të mirëqenies sociale. Të gjitha sistemet politike që kanë funksionuar në Shqipëri, asnjëherë nuk kanë arritur të ndërtojnë një rrjetë mbrojtëse sociale, si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë privat. Sidoqoftë, mungesa e eksperiencës në drejtim të ngritjes, shtrirjes dhe menaxhimit të shërbimeve shoqërore nuk mund të justifikojë mungesën e tyre në Shqipëri, 21 vjet pas rrëzimit të sistemit komunist.
- Ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nuk parashikon sanksione në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi. Mosndëshkimi i këtij fenomeni mund të sjellë si pasojë jo vetëm mbajtjen e *status quo*-së ekzistuese, ku fëmijët shfrytëzohen për lypje dhe prindërit nuk ndëshkohen, por edhe krijimin e një precedenti për rritjen e vazhdueshme të numrit të fëmijëve në situatë rruge në të ardhmen.
- Së fundi, shoqëria civile ka mbështetur me nisma lokale një pjesë të mirë të fëmijëve në situatë rruge. Mungesa e mbështetjes financiare për shërbimet e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe kombëtar, ka bërë që këto nisma të mos kenë shtrirje kombëtare por vetëm të zbatohen si programe pilot të cilat, po të financoheshin nga ana e Qeverisë, mund të ndihmonin me shërbime sociale dhe ekonomike çdo fëmijë, të ri dhe familje që gjendet në situatë varfërie, përjashtimi social dhe mungese të mjeteve bazë për të jetuar.

7. Rekomandime

Rekomandimet mund të grupohen duke ju referuar aktorëve të ndryshëm dhe përgjegjësive e mundësive që ata kanë për të kontribuar në eliminimin e problemeve dhe vështirësive:

7.1 Rekomandime për qeverinë

Fëmijët në situatë rruge përjetojnë një sërë kufizimesh të lidhura me kushtet e jetesës, arsimin, shërbimin shëndetësor dhe aktivitetin e moshës. Prindërit e tyre nuk kanë forcën dhe mundësinë për të influencuar në politikëbërje dhe vendimmarrje në favor të interesave të fëmijëve të tyre. Për këto arsye, qeveria duhet të jetë shumë më e ndjeshme dhe e prirur të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve të tyre nëpërmjet:

- ngritjes së Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë njësive bashkiake në Tiranë ku shfrytëzimi i fëmijëve për lypje dhe punë është në nivele shumë të larta;
- hartimit të politikave sociale për fëmijët në situatë rruge shumë më fleksibël dhe më të realizueshme nga institucionet publike dhe jopublike;
- hartimit të strategjive dhe planeve të veprimit me synime dhe ndërhyrje konkrete;
- ndërtimit të një sistemi mbrojtjeje për fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët në përgjithësi, të përbërë nga një sërë shërbimesh të lidhur në rrjet dhe komplementar me njëri-tjetrin;
- përcaktimit të shërbimeve që ofrohen nga shteti dhe atyre që ofrohen nga organizatat lokale, rajonale dhe kombëtare;
- përcaktimit me ligj të përgjegjësive të shkollave dhe njësive të qeverisjes vendore lidhur me shërbimin dhe qëndrimin ndaj fëmijëve;
- sanksionimit me ligj të praktikave lehtësuese të regjistrimit në gjendjen civile të fëmijëve në situatë rruge;
- sanksionimit me ligj të penaliteteve për familjarët, njësitë e qeverisjes vendore dhe shkollat që nuk sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në situatë rruge;

Rekomandime në lidhje me Kodin e Familjes

- Kodi i Familjes duhet të përfshijë edhe aspektet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje apo neglizhenca, qartësimin e mëtejshëm të përgjegjësive dhe detyrimeve prindërore si dhe subjektet dhe procedurat që mund të ndiqen për heqjen ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore.

Rekomandime në lidhje me Kodin Penal

- Në Kodin Penal duhet të përfshihet një nen specifik për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna emocionale, neglizhenca apo forma të tjera të abuzimit e keqtrajtimit.
- Duhet të realizohet kriminalizimi i shfrytëzimit të fëmijëve për lypje si dhe forma të tjera të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve si një mundësi për të ndëshkuar të gjithë personat që kërkojnë të nxjerrin përfitime dhe të ardhura nga puna e fëmijëve. Kjo duhet të shoqërohet me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse për heqjen ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, nëse shfrytëzuesit e fëmijëve janë prindërit, dhe me kërkesën për vendosjen e fëmijës në qendra rezidenciale apo në familje kujdestare në interesin më të lartë të tij;

Rekomandime në lidhje me Ligjin për Kujdesin Shëndetësor

- Ligji për Kujdesin Shëndetësor duhet përmirësuar duke ligjëruar ofrimin e shërbimeve shëndetësore parësore falas për të gjithë fëmijët e varfër dhe ata që jetojnë në situatë rruge apo në situata emergjence, pavarësisht nga vendndodhja e fëmijës apo e prindit/kujdestarit ligjor të tij;
- Ministri i Shëndetësisë duhet të miratojë një rregullore të posaçme ku të specifikohen rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen për dhënie falas të shërbimeve mjekësore bazë për fëmijët e varfër dhe fëmijët në situatë rruge apo në situata emergjence dhe subjektet që mund të paraqiten për ta kërkuar këtë ndihmë në emër të fëmijëve (p.sh. rasti i OJF-ve që ofrojnë shërbime);

Rekomandime në lidhje me ligjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbështetjen me shërbime sociale

- Për shkak edhe të specifikave që ka dhuna ndaj fëmijëve, përgatitja e një ligji të posaçëm për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë keqtrajtimi, përfshirë edhe procedurat e administrimit të rastit dhe përgjegjësisë prindërore, mund të krijojë premisa për një mbrojtje më adekuate të fëmijëve nga dhuna në familje dhe më gjerë;
- Ligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore duhet rishikuar për të zgjidhur të gjitha aspektet e mosfunksionimit të ndihmës ekonomike dhe akoma më tepër ato të shërbimeve sociale. Rishikimi i këtij ligji është një emergjencë pasi, për shkak të mangësive që ka zbatimi i tij, shumë fëmijë nuk përfitojnë as nga skema e ndihmës dhe as nga ajo e shërbimeve shoqërore;
- Ndihma ekonomike që jepet nga institucionet vendore dhe nga buxheti i shtetit ka nevojë për një reformë të mëtëjshme dhe duhet të jepet e kombinuar me shërbime falas në komunitet. Niveli i ndihmës duhet të përcaktohet në ligj dhe jo në VKM, për të shmangur të gjitha abuzimet apo keqpërdorimet e saj nga ana e pushtetit vendor;
- Bërja funksionale e Fondit Shoqëror apo edhe e një Nënfondi për Mbrojtjen e Fëmijëve brenda tij do të ishte një mundësi shumë e mirë që vetë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve të financonte shërbime në mbrojtje të fëmijëve në nivel kombëtar.
- Në Ligjin 9355 duhet përmirësim, sa më shpejt që të jetë e mundur, në drejtim të procedurave të mbledhjes dhe administrimit të dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore. Mbledhja dhe administrimi i këtij dokumentacioni duhet të bëhet nga vetë institucionet dhe jo nga personi që kërkon të përfitojë ndihmë dhe shërbime.
- Në Ligjin 9355, roli i administratorit social në Bashki dhe Komunë duhet forcuar nëpërmjet përfshirjes së tij në stafin e Njësive të reja të Mbrojtjes së Fëmijëve; dhënies së përgjegjësisë për administrimin e rastit; dhënies së statusit të punonjësit social; të drejtës për të pasur mbrojtje nga policia kur e kërkon rasti; të drejtës për të

vizituar çdo banesë ku jetojnë fëmijë; koordinimit të punës së tij me atë të mësuesve, administratës rajonale të punësimit etj; të drejtës për të përgatitur kërkesat për heqjen apo kufizimin e përgjegjësive prindërore dhe për t'iu drejtuar gjykatës etj.

- Në Ligjin 9355 ka nevojë për një përmirësim të mëtijshëm në mënyrë që ky ligj t'u përgjigjet të gjitha realiteteve të reja dhe nevojës për një koordinim më të mirë të shërbimeve, jo vetëm shoqërore por edhe arsimore, të punësimit, të formimit profesional etj., në nivel rajonal dhe bashkiak, nëpërmjet tenderimit dhe blerjes së shërbimeve ekzistuese dhe shtimit të gamës së shërbimeve të reja, sidomos atyre në komunitet dhe atyre për familjen. Kjo do të kërkonte në mënyrë të posaçme shtimin e stafëve multidisiplinare, miratimin e procedurave të reja për referimin, ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve dhe koordinimin e tyre me shërbimet e tjera shumëplanëshe, publike e private.

7.2 Rekomandime për shoqërinë civile

Organizatat jofitimprurëse mund të kontribuojnë në disa drejtime më mirë se deri më tani për të përmirësuar situatën që përjetojnë fëmijët në situatë rruge. Kështu:

- ato duhet të punojnë më shumë, përmes mediave dhe kontakteve me agjencitë qeveritare, për të kërkuar respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- ato duhet të punojnë për monitorimin e procesit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në situatë rruge duke tërhequr, përmes shifrave dhe fakteve, vëmendjen e institucioneve publike dhe jopublike;
- organizatat e shoqërisë civile mund të punojnë më mirë se sa deri më tani për të ndërgjegjësuar institucionet dhe publikun rreth situatës së fëmijëve në situatë rruge dhe nevojave e rreziqeve që u kanosen atyre dhe për të zbutur qëndrimet diskriminuese e përjashtuese që ndeshen në praktikën e përditshme;
- organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë me programe mbështetëse për të parandaluar daljen në rrugë të fëmijëve përmes ndihmës dhe mbështetjes së prindërve; në këtë rast, këto

organizata mund të kërkojnë edhe mbështetjen e aktorëve të ndryshëm lokalë si p.sh. biznesi;

- programet e rrugës janë një mundësi tjetër e organizatave të shoqërisë civile për të kontribuar. Këto janë programe që përdoren për të eliminuar pjesën më të rëndë të problemeve të fëmijëve në situatë rruge duke u ofruar atyre shërbime në rrugë. Zakonisht, këto janë shërbime më të thjeshta, më pak të kushtueshme dhe u mundësohen një numri më të madh fëmijësh. Të tilla mund të jenë:
 - programet e ushqimit
 - shërbimet mjekësore
 - shërbimet ligjore
 - edukim në rrugë
 - bashkimi familjar
 - ngritja e çadrave për gjumë dhe kujdes për veten
 - programe të tjera që i sjellin fëmijët më pranë agjencive si kënde lojërash, aktivitete argëtuese etj.
 - ndërgjegjësimi i fëmijëve në situatë rruge - përgatitja e tyre për ta parë veten si qytetarë me të drejta të barabarta dhe jo si përfitues pasivë të shërbimeve.

8. Literatura e përdorur

PANGAEA - Street Children - Community Children Worldwide Resource Library

<http://www.mexico-child-link.org/street-children-definition-statistics.htm>

<http://www.worldvision.com.au/onebigvillage/print.asp?topicID=73>

<http://www.mexico-child-link.org/street-children.htm>

Latin American Mission

“State of the World’s Street Children-Violence” (PDF). www.streetchildren.org.uk Retrieved 2008-02-05

Laura Del Col, West Virginia University, The Life of the Industrial Worker in Ninteenth-Century England

“Street Children:WHO 3 of 9”. www.pangaea.org. Retrieved 2008-02-05.

At Risk, Roma and the Displaced in Southeast Europe, UNDP, 2006 De Soto and others, 2002

Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2008-2013

Kushtetuta e Shqipërisë (1998)

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (1995)

Kodi i familjes (2004)

Ligj nr. 10 347, datë 4.11.2010, Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

Ligj nr. 10 279, datë 20.5.2010 Për Kundërvajtjet Administrative

Ligj nr. 7870, datë 13.10.1994, Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë

Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006, Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare

Ligj nr. 10 107, datë 30.3.2009, Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë

Ligj nr. 10 138, datë 11.5.2009, Për Shëndetin Publik

Ligj nr. 9928, datë 9.6.2008, Për Shërbimin Shëndetësor Stomatologjik në Republikën e Shqipërisë

Ligj nr. 8615, datë 1.6.2000 , Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë

Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 857, datë 20.12.2006, Për Financimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor nga Skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 12.04.2012, “Për Procedurat e Kryerjes së Kontrollit dhe Vendosijes së Sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen E të Drejtave të Fëmijëve”

Urdhër Nr. 95 i Ministrit të Shëndetësisë, datë 16.02.2009, për Miratimin e Paketës Bazë të Shërbimeve për Kujdesin Shëndetësor Parësor

Urdhër Nr. 526 i Ministrit të Shëndetësisë, datë 12.10.2009, për Zbatimin e Sistemit të Referimit të Pacientëve në Shërbimin Shëndetësor

Kontrata TIP e ISSHP me Qendrën Shëndetësore



Save the Children

Legislation and public services for children in street situation



This project is funded by the European Union

This publication has been produced in the framework of **Save the Children** project” Protection and Integration of street children in Tirana “with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of the authors and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.

© Save the Children

All rights reserved. The contents of this publication may be freely used or copied for non-commercial purposes, provided that any of such reproduction is accompanied by acknowledgement of Save the Children as the source.

Save the Children

Rruga “Komuna e Parisit ”, Lagja 8, Pallatet I Maji, Vila “ Lami”

Tirana – Albania

Tel: 00355 4 261 840, 929; Fax: 00355 4 263 428

E-mail: info.albania@savethechildren.org

<http://www.scalbania.org>



Save the Children

Legislation and public services for children in street situation

STUDY REPORT

Prepared by the Children's Human
Rights Centre of Albania, CRCA

Assoc. Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri
Altin Hazizaj, Barrister at Law

Translated and edited by Olta Çakçiri

Tirana, October 2011

ACKNOWLEDGMENT

This study report was made possible by contribution of:

- 1) Team of professionals of the Centre for Children in Street Situation working on the Save the Children project: “Protection and Integration of Children in Street Situation”
- 2) Children of the World and of Albania - Human Rights (FBSH), Albanian organization partner in the project
- 3) ARSIS - Social Organization for the Support of Youth, collaborator in the project
- 4) The Children’s Human Rights Centre of Albania (CRCA/DCI Albania) and its team of researchers: Assoc. Prof. Edlira Haxhiymeri and Altin Hazizaj Barrister at Law, Doctoral Candidate in Juridical Science

We are grateful to the contributors group of all the professionals working in sectors directly related to public services for children in street situation such as the health sector, the education sector, the police and the municipal units (social administrators) of Tirana.

Special thanks go to children and their families who were consulted during the preparation of this study report.

Contribution in preparation of this study report was given by:

Mrs. Blerina Kashari, Child Protection Program Manager, Save the Children in Albania

Mrs. Mirela Jonuzaj, Child protection Program Coordinator, Save the Children in Albania

Mrs. Nertila Topulli, Manager of the Center for children in street situation

Mrs. Klara Simoni, Executive Director of FBSH

Mr. Zini Kore, Executive Director of ARSIS

CONTENT

1. Aim of the study	5
2. Children in street situation: a national and global phenomenon.....	10
3. Methodology of the study.....	12
4. Protection and care for children in street situation in Albania.....	13
5. Legislation and children in street situation	26
6. Conclusions	53
7. Recommendations	58
8. Literature used	63

Abbreviations

ARSIS - Social Organization for the Support of Youth

FBSH - Children of the World and of Albania - Human Rights

ILO - International Labor Organization

MoES – Ministry of Education and Science

MoLSAEO - Ministry of Labor, Social Affairs and Equal Opportunities

CPU – Child Protection Unit

WHO - World Health Organization

UN - United Nations

NPO - Non Profit Organization

DCM - Decision of the Council of Ministers

I. Aim of the study

This study report has been prepared in the framework of the project Save the Children is implementing in Tirana since 2009 through the “Centre for children in street situation”¹ in partnership with the Municipality of Tirana and the Albanian NPO, Children of the World and of Albania - Human Rights (FBSH).

**“Centre for children in street situation”
Save the Children, Municipality of Tirana, Children of the
World and of Albania-FBSH**

**A MODEL OF PROTECTION AND INTEGRATION OF
CHILDREN IN STREET SITUATION**

The Centre for children in street situation started its activity in February 2009 as a joint initiative of Save the Children and the Municipality of Tirana, in partnership with the Albanian association Children of the World and of Albania, FBSH.

The main goal of this centre is to provide and ensure support to children in street situation and protect them from all forms of exploitation. The centre welcomes all children based on their free will and on their parents’ or relatives consent. The services and support provided by the Centre for children in street situation are performed *in full respect of the principles of the UN Convention on the Rights of the Child*.

1. During this study report we will use the term “children in street situation” which includes all groups of children who live and work in the streets and cope with street experience.

The activity of the centre for children in street situation is also based on consultations with beneficiary children and the participation of these children in the development and planning of *for-and-by-children* activities.

The centre for children in street situation provides services for children and their families in and out of the centre premises.

The activities organized in the centre for children in street situation are:

- Preparatory classes (basic knowledge on writing, reading and mathematics) for children at the age of entering the mainstream education system
- Preparatory classes for children who have passed the limit age of admission to mainstream education system (basic knowledge on writing, reading and mathematics and general knowledge)
- Support classes for children enrolled in mainstream education system
- Focus and information groups with children and adolescents on topics related to children rights, safety and healthy growth (as per age range and gender)
- Psycho-social and educational activities as per age range and gender
- Recreational, cultural and sports activities
- Computer courses organized by age group
- Social-cultural mediation on Roma and Egyptian culture
- Counseling and discussions with community representatives

All activities carried out in the centre are supported and facilitated by a staff of professionals which includes social workers, psychologists, animators, cultural mediators, social teachers and the management staff. The methodology applied by the centre for children in street situation project is cultural mediation, which consists of establishing a trust relation with children and the communities they belong to.

The centre welcomes every day children's parents and other family members providing them with consultations, counseling and information related to public services; facilitating them in following administrative procedures and referring them to public services if needed.

One of the main elements of the activity of the Centre is outreach work conducted by the outreach unit. This unit is composed of social workers and cultural mediators who periodically visit *the community where children and their families work and live* in order to:

- *monitor and evaluate socio-economic conditions of children and their families*
- *identify, document and address problems and needs*
- *inform children's parents/relatives on the existence of public services and on their rights and responsibilities*

The work is focused on mediation and support provided to children in street situation and their families in order for them to benefit from public and private services. Mediation is mainly related to the:

- registration of all children identified as nonregistered in the National Registry Offices, by completing necessary documents and following required procedures
- vaccination of all children identified as unvaccinated
- medical check-ups and support with medicines of children in health institutions
- enrollment of children in preschool and mainstream education systems, providing them preparatory classes and didactic materials and monitoring their attendance and academic results.
- enrollment of adolescents in vocational training courses, providing them preparatory classes and training materials and monitoring their attendance and progress.

Cooperation between public and nonpublic actors to ensure protection and support to street children and contribute in their healthy development is considered the key element of this project's implementation.

Child Protection Working Group for the protection and integration of children in street situation

“Protection and integration of children in street situation” Project, implemented through the Centre for children in street situation, focuses on the capacity building of professionals working in sectors directly related to service provision such as education, health and social service as well as those of the related offices of Tirana Municipal Units and police structures, aiming at meeting their needs and ensuring their rights are respected. The achievement of objectives and the accomplishment of project’s daily tasks required, since the beginning of the functioning of the centre, a close collaboration with central and local government structures such as Regional Education Directorate, Regional Health Agency, Health Centers, 9-year schools directorates, Social Services in Municipal Units and the Police Directorate in Tirana.

Thus, a Child Protection Working Group was established with representatives of all the abovementioned structures aiming at their capacity building and at the development and application of a model of multidisciplinary approach in working with children in street situation. The commitment of these institutions consisted of the approval of an inter-institutional agreement that defines their institutional engagement and the continuity of their contribution as related to their participation in the project and the provision of services for children in street situation.

More than 20 professionals of the abovementioned sectors, members of this group, have taken active part in the sessions¹ organized for their capacity building and their preparation in the field of child protection bringing specific cases from their daily work, identifying and documenting the problematic and discussing within the multidisciplinary group the solutions they have found guided by the best interest of the child.

The study report was drawn up based on reports, studies and data directly collected from interviews conducted with professionals, mothers and children who had experience with street life and other problems

1. May 2010 – September 2011

related to privations and obstacles to normal life.

At the same time, the report centers on the analysis of laws and policies at national and international level with the purpose to observe what is the protection provided by the law to children in street situation in Albania and, above all, what are the gaps in the legislation for what concerns adequate protection and care for children in street situation and their families who want to leave the street by integrating into the labour market or into the welfare system.

After analysis of first-hand and second-hand data, the study report identifies the most acute problems this category has to deal with and provides a list of recommendations addressed to the various institutions and stakeholders committed in the mitigation and solution of this problem.

The study report aims at:

- identifying legislation gaps and difficulties encountered in the implementation of the law as related to the provision of social services for children in street situation.
- analyzing the role of central and local child protection government structures and mechanisms (State Social Service, Child Protection Units, social administrators, etc.)
- identifying the difficulties encountered in the coordination between structures and mechanisms.
- evaluating the factors that stimulate child exposure to street work.

2. Children in street situation: a national and global phenomenon

The United Nations Organization made an estimation of the number of children in street situation in the world concluding it reaches 150 million and tends to increase. Again according to the UN, the age range of children in street situation is 3-18. 40% of them are homeless; the other 60% works in the street to provide food for their families. A significant number of children in street situation are forced by their extremely poor parents to beg or to work. It is impossible for them to attend school and they are considered to be living “in extremely difficult conditions”. Children in street situation are increasingly becoming unprotected victims of brutal violence, sexual exploitation, neglect, substance dependence and infringement of human rights¹. A large variety of cases are referred in the reports of different countries on children in street situation, such as those of children coming from poor families; orphans; abandoned children; children coming from one-parent families, divorced parents families or children of parents having health or alcohol problems; children coming from Roma families and so on. All of them are, one way or another, obliged to go in the street in order to provide means of living for themselves and their families.

UNICEF has defined three types of street children: *street living children*, *street working children* and *children from street families*.

The definition of children in street situation has stimulated many debates which have found a generalization in the “State of the World’s Street Children: Violence” Report of Sarah Thomas de Benitez.

She says that, according to many sociologists and anthropologists, ‘street children’ do not form a clearly defined category; this category does not include a homogeneous population and the phenomenon itself remains undefined (Glaser, 1990; Ennew, 2000; Moura, 2002). The term ‘children in street situation’ covers children in such a wide variety

1. PANGEA - Street Children - Community Children Worldwide Resource Library

of circumstances and characteristics that policy-makers and service providers find it difficult to describe and target them. Upon peeling away the 'street children' label, individual girls and boys of all ages are found living and working in public spaces, visible in the great majority of the world's urban centers¹.

Children end up in the streets for many reasons. They may not have any other choice; they may have been abandoned or rejected by their parents or may be orphans. Or, they may choose to live in the street due to maltreatment or neglect or due to their families not being able to meet their basic needs.

Many children work in the streets because their families need the money they make in the streets. Families are part of the society and their poverty and misery is an indicator of the social, economic, political and environmental problems the society is going through.

The report of WHO in 1993 lists the following causes of exposure to street experience²:

- family breakdown
- armed conflict
- poverty
- natural and man-made disasters
- famine
- physical and sexual abuse
- exploitation by adults
- dislocation through migration
- urbanization and overcrowding
- social exclusion/discrimination
- parental rejection

1. Page 8, Section 2.2. "State of the World's Street Children-Violence" (PDF). www.streetchildren.org.uk. Retrieved 2008-02-05

2. "Street Children:WHO 3 of 9" . www.pangaea.org. Retrieved 2008-02-05.

3. Methodology of the study

3.1 Main research tools

The experts who worked in the drawing of this study report used the cross-check analysis methodology with primary and secondary sources. Primary information was collected through interviews conducted with representatives of government institutions and non governmental agencies working with and for children in street situation. Focus groups and interviews with children and youths were also organized.

Secondary data was enabled by the existing Albanian and foreign literature. The use of the existing literature (studies, reports, articles written by local scholars and national and international organizations, laws and policies of the Albanian government from 1990 to date) served in identifying the problematic on which to investigate and the gaps in the legislation, especially for what concerns its implementation.

Interviews with key stakeholders related to the services for children in street situation, interviews with professionals (medical doctors, teachers, police officers, layers, social workers and psychologists) as well as those with parents and children in street situation served to prove the existence of specific problems, identify their level of gravity, their causes and the needs for interventions and obtain the suggestions of all interested actors.

3.2 Difficulties encountered in the preparation of the study report

Experts encountered a number of difficulties and obstacles during the preparation of the study report. In most of the cases these were overcome by using secondary sources or double-checking techniques.

Experts had to deal with the lack of specific studies on child exploitation for economic reasons and begging as a social phenomenon and of quantitative data on children and families living in street situation. Though not a determining factor, the existence of such base of knowledge

would have helped experts in their effort to perform a comparative data analysis and identify tendencies. But, most of the existing studies only address child trafficking, being this a largely diffused phenomenon in Albania since years now.

Another difficulty was the lack of specific statistics/data on other forms of child exploitation.

4. Protection and care for children in street situation in Albania

There is no study at national level which would be able to provide a full view of the phenomenon of children in street situation in Albania. In such conditions, it is really hard to assess the dimensions of the phenomenon, children's profile, their background and the causes of the phenomenon comparatively (i.e. what has been the situation in the past and if it has been improving or worsening during the years).

However, we will use the abovementioned definition in relation to their classification. The study report will focus on children, with or without families, who spend most of the day in the street and do not go to school, being exposed to many risk factors since they lack access to health and social services.

4.1 Is begging and living in the streets a phenomenon related to Roma community?

While trying to investigate on the origins of children in street situation who are the object of our study report, we continuously came across the opinion of specialists of different fields that "most children in street situation belong to Roma community". This study report refuses to take this statement as an absolute truth for as long as it is not based on facts (figures and concrete facts on all children in street situation).

Based on the evidences of the "Protection and Integration of children in street situation" Project, we recognize that most of the children in street situation come from the Roma community, but consider this

group of children at risk to be a mixed group composed also by children belonging to other communities and social groups.

4. 2 What happens during the practice of working with children in street situation?

4.2.1. Children in street situation and their right to basic education

According to interviews with specialists, “children who have been exposed to street experience have difficulties in being accepted by their social environment, including by teachers.”

Albania has approved the Law on Pre-University Education and the National Strategy on Pre-University Education, two important documents for the development of education in the country. Both these legal and policy documents constitute the basis on which the practice of the Albanian government in applying general and constitutional principles is built. Among other things, these documents state the aim to ...*increase the inclusion in compulsory education of children coming from poor families.* The documents foresee the introduction of preparatory classes for children in need, including Roma children, in order to get them ready to enter the first grade¹.

The MoE Progress Reports state that during the 2003-2004 period this Ministry distributed free schoolbooks for children in need, including children belonging to Roma community. During the 2004-2007 period, free schoolbooks were distributed for children of unemployed parents. During 2008, children of parents on welfare only had to pay the 10% of the cost of schoolbooks². On 2009, a Decision of the Council of Ministers (DCM) enabled a reimbursement of 100% for the schoolbooks of primary education children coming from families in need supported by social aid.

The 2007 Progress Report points out the fact that “books, unfortunately, arrive too late and Roma parents cannot benefit from this aid. They are

1. Page 17, National Strategy for Pre-University Education

2. Progress Report of the National Strategy for Pre-university Education 2007, pg. 29

not registered as unemployed and do not meet the criteria for economic assistance. According to 2007 procedures, parents firstly had to buy the books themselves and would be 100% or 90% reimbursed afterwards. Roma parents had no revenues, the reimbursement delayed and, as a consequence, many of them did not benefit from it¹". This situation seems to be overcome now thanks to the sub legal acts issued during the last years. However, despite the approval of the related DCMs (DCM No. 212, dated 16.03.2011 On some supplements and an amendment on Decision No. 107, dated 10.02.2010, of the Council of Ministers "On the publication, printing, distribution and sale of school textbooks for the pre-university educational system"), the problem is not definitively solved yet.

Following, there are some opinions of specialists:

One of them says: 'Education of children coming from poor (Roma or non-Roma) families remains a problem. The right to education is one of children's basic rights, defined by the Constitution which provides that compulsory education in public schools is free of charge. Sub legal acts such as the Dispositions for pre-university education define parents, local government and education institutions' obligation to guarantee education for all children at school age. The Dispositions for pre-university education also define the penalties for lawbreakers.

What happens in reality is far from what provided by the legislation. Parents with low or no income cannot afford the costs of their children's schooling. In some cases they are unemployed. They can neither be obliged to send their children to school nor penalized for not doing so. It is impossible for local government units to enforce law implementation and at the same time they are incapable to provide alternative solutions in order to guarantee the observance of these children's fundamental constitutional right to compulsory education. Often these children are not identified and get lost in the vortex of everyday life.'

'When families are not able to guarantee children's education, local governments have no power to enforce law implementation. The school as an institution is not linked to the child protection and care system. Schools have no legal obligation to keep the child enrolled. The school, with all its structure, is

1. Same as above

not able to carry out the implementation of children's right to education'— says another specialist.

In a time in which there is so much talking about lifelong learning and in which the modern society tries to create suitable conditions for the citizens of all ages to get back to studies, even if it is just to refresh their knowledge, children are denied their right to education and this is a discrimination which represents an infringement of all the laws mentioned above.

The specialists interviewed express their concern about the fact that the education environment is not supportive towards street children and other categories of children in difficult situations.

One of them tells us: 'A Roma girl came to our school to enroll in first grade. She was always staying apart because other children did not accept her. All children in the class tried at every occasion to point out the differences of her behavior. They even started to observe what she was doing after the classes. They saw her collecting cans in the garbage and started to point at her. She felt bad. Meanwhile, the school didn't do anything to protect her. She left in silence. No one took care of her. Children were taught to be prejudiced by their prejudiced parents. There are cases in which non-Roma parents ask for the exclusion of Roma children from their child's class. Teachers also proved to be as prejudiced as parents. Cases have been recorded of headmasters refusing to allow Roma children or children in street situation to enroll in their schools.'

Other specialists state:

'DCM for the distribution of free schoolbooks for Roma children and DCM for the reimbursement of books for children coming from families with limited revenues have not been implemented. Roma children do not take their books for free because some of them do not even go to school since they have not been registered in the National Registry Office. Children of poor families do not have money to firstly buy the books and, as a consequence, there can be no reimbursement for them.'

'Sub legal acts seem to be superficial and not functional. They are not accompanied by implementation procedures.'

‘Children who go to school without books are punished, humiliated and, in a certain way, sent out of the class.’

‘Children are sent out of the class and humiliated also when they do not have the necessary school materials.’

‘The position taken by the school is the opposite of what expected from it; the school turns into a prejudiced and excluding environment for those children who are not able to afford the necessary school materials.’

In some cases, parents perpetuate this attitude asking for the expulsion of black children or children who do not have the school supplies needed.

